

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5770
E martë, 7 maj 2019
çmimi 0.40 €

Uran Ismaili, kandidat
për kryetar të Degës së
PDK-së në Prishtinë

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

**FILLON KAMPANJA
VETËDIJESUESE 'POTENCIALI
I RINISË SË KOSOVËS
DREJT BE-së'** F. 2



**KRYHET NJË OPERACION I
RRALLË TE NJË FËMIJË NË
OKUK** F. 7

**VESELI DHE HARADINAJ
PRITËN NË TAKIM
PËRFAQËSUESIT E PARTIVE
OPOZITARE NGA SHQIPËRIA**

F. 6

EKONOMI

**HARADINAJ OFRON
PËRKRAHJEN E QEVERISË
PËR ZGJIDHJEN E
PROBLEMEVE NË TELEKOM** F. 9

**UJËSJELLËSI PRISHTINA:
UJI, 100 PËR QIND I SIGURT**

F. 8

KULTURË

**SHËN GJERGJI, FESTË
PAGANE E QYTETËRIMIT
TË LASHTË** F. 12

Prof. dr. Vebi BEXHETI

SPORT

**LIVOREKA: DRITA DO TË
ANGAZHOHET MAKSIMALISHT
EDHE NDAJ FERONIKELIT** F. 16

FLET PËR "EPOKËN E RE", AGIM BAHTIRI ■ FAQE 4-5

Qeveria duhet të japë dorëheqje

Nënkryetari i Aleancës Kosova e Re (AKR), njëherësh kryetar i Komunës së Mitrovicës së Jugut, Agim Bahtiri, ka kritikuar qeverisjen e deritanishme të koalicionit PAN. Ai ka thënë se ky koalicion po qeveris në mënyrë çoroditëse meqë nuk ka platformë të përbashkët për t'i çuar proceset përpara. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Bahtiri ka deklaruar se një qeveri e cila nuk ka

koncept dhe vizion nuk mund të ketë sukses. Prandaj, ai ka vlerësuar se qeveria aktuale duhet të japë dorëheqje. Bahtiri ka folur edhe për zgjedhjet në AKR, duke iu bërë thirrje qytetarëve që t'i bashkohen këtij procesi për të mirën e vendit. Ai i ka falënderuar qytetarët e Mitrovicës për mbështetjen që i kanë dhënë për t'u rizgjedhur kryetar i AKR-së në këtë komunë



Nisin formalisht procedurat për formimin e tribunalit ndërkombëtar për krimet serbe në Kosovë

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka nisur të hënën edhe formalisht procedurat për formimin e tribunalit ndërkombëtar për krimet që Serbia i ka kryer gjatë luftës në Kosovë. Duke folur para përfaqësuesve të shoqatave të të pagjeturve, organizatave të dala nga lufta, institucioneve të drejtësisë dhe institucioneve të tjera të pavarura, ai ka thënë se kriminelët serbë ende nuk



janë gjykuar për mijëra krime dhe viktime në Kosovë ■ FAQE 3



**Heroi Luan
Haradinaj
ishte
bërthama
e parë e
UÇK-së** ■ FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, Vite, p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Thaçi dhe Haradinaj urojnë presidentin e ri të Maqedonisë Veriore

PRISHTINË, 6 MAJ - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, i ka dërguar një telegram urimi homologut të vet të ri në Maqedoninë Veriore, presidentit të zgjedhur Stevo Pendarovski.

Presidenti Thaçi ka shkruar se Republika e Kosovës dhe Republika e Maqedonisë së

Veriut kanë lidhje të përzemërta dhe themele të forta që mbështeten në dëshirën e përbashkët për ta nxitur bashkëpunimin reciprok në të gjitha fushat.

Po ashtu, presidenti Thaçi i ka përgëzuar edhe subjektet politike shqiptare në Maqedoninë e

Veriut, të cilat u dëshmuar konstruktive, duke bërë thirrje për pjesëmarrje masive në këtë proces zgjedhor. Edhe kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, ka uruar Stevo Pendarovskin për zgjedhjen e tij president i Maqedonisë së Veriut. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në

"Facebook" ka thënë se Kosova është gjithmonë e gatshme për thellimin e bashkëpunimit me Maqedoninë e Veriut. "Urime qytetarëve të Maqedonisë së Veriut për zgjedhjet e lira e demokratike presidenciale! Me këtë rast i urojmë fitoren presidentit të zgjedhur, Stevo Pendarovski.

Kosova është gjithmonë e gatshme për fuqizimin e bashkëpunimit dhe avancimit të marrëdhënieve të mira me Maqedoninë e Veriut, në të mirë të të dy popujve tanë, të forcimit të bashkëpunimit rajonal dhe të perspektivës sonë euro-atlantike", ka shkruar Haradinaj.

Hoxha: Kampanja për Ditën e Evropës është pro vlerave evropiane

"Kosova është i vetmi vend evropian që shënon 9 Majin, Ditën e Evropës. Kjo dëshmon orientimin tonë evropian. Edhe pse ende nuk e gëzojmë lirinë e lëvizjes, Kosova përbën vendin më proevropian. Presim që BE-ja ta ndërmarrë hapin e radhës për t'i hapur rrugë dhe mundësi rinisë së Kosovës. Kosova meriton liberalizimin", ka thënë ministrja Dhurata Hoxha në kampanjën për Ditën e Evropës



EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 6 MAJ - Të hënën ka filluar kampanja vetëdijesuese me temë "Potenciali i rinisë së Kosovës drejt BE-së" nën organizimin e Ministrisë së Integritimit Evropian dhe Zyrës së BE-së në Kosovë. Takimi i parë është mbajtur në Prishtinë, ku kanë qenë të pranishme ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, shefja e Zyrës së BE-së në Kosovë, Natalya Apostolova, Behije Murtezi, balerinë e Baletit Kombëtar të Kosovës, Hana Qerimi, themeluese e "Shkollës Digjitale" si dhe studentë e të rinj. Me këtë rast, ministrja Hoxha ka thënë se është kënaqësi e veçantë të flasë për rininë kosovare si një ndër potencialet më të mëdha që ka Kosova. Duke folur për gjend-

jen para dhe pas çlirimit të vendit, ajo ka theksuar rëndësinë e integritimit në organizatat ndërkombëtare.

Sipas ministres Hoxha, Kosova tashmë meriton liberalizimin e vizave. "Kosova është i vetmi vend evropian që shënon 9 Majin, Ditën e Evropës. Kjo dëshmon orientimin tonë evropian. Edhe pse ende nuk e gëzojmë lirinë e lëvizjes, Kosova përbën vendin më proevropian. Presim që BE-ja ta ndërmarrë hapin e radhës për t'i hapur rrugë dhe mundësi rinisë së Kosovës. Kosova meriton liberalizimin", është shprehur Hoxha, duke shtuar se institucionet e Kosovës janë të përkushtuara që potenciali rinor të ketë perspektivë të qëndrueshme. "Edhe BE-ja vazhdimisht e mbështet rininë e Kosovës me projekte të shumta që kanë të bëjnë me përmirësimin e sistemit arsi-

mor, shkollimit profesional, përmirësimin e infrastrukturës sportive, kulturore, mundësitë për shkollim dhe programe shkëmbimi me universitetet më prestigjioze të Evropës", ka theksuar ministrja Hoxha. Ndërsa shefja e Zyrës së BE-së në Kosovë, Natalya Apostolova, ka vlerësuar se të rinjtë janë pasuria më e vlefshme e Kosovës. "Rinia e shtyn përparimin dhe ata duhet të pajisen me aftësi për të qenë konkurrues në tregun e punës dhe për të kontribuar në zhvil-

limin e Kosovës. Në BE ne mbështesim të rinjtë duke e bërë arsimin prioritet. Mbështesim ristrukturimin e sektorit të arsimit dhe ndihmojmë mësuesit me parime që të marrin njohuri për shkollimin modern. Ne ofrojmë mundësi për të studiuar jashtë vendit nëpërmjet programit Erasmus +. Autoritetet e Kosovës gjithashtu duhet të angazhohen më shumë, t'i riorganizojnë prioritetet dhe të investojnë në arsim dhe punësim për rininë", ka deklaruar Apostolova.

Ndërsa Behije Murtezi, balerinë e Baletit Kombëtar të Kosovës, ka vlerësuar kapacitetin e rinisë së Kosovës, por ka thënë se duhet mbështetje për ta shfaqur kapacitetin e vet krahas rinisë evropiane. Kurse Hana Qerimi, themeluesja e "Shkollës Digjitale", ka diskutuar për potencialin e rinisë në fushën digjitale, me ç'rast ka folur për një storie shumë të suksesshme personale me më shumë se 10 qendra në Kosovë dhe në tri shtete të tjera.

Oettinger: Gjermania mbështet hapjen e negociatave të Shqipërisë me BE-në

TIRANË, 6 MAJ - "Gjermania i jep përkrahje të plotë Shqipërisë dhe mbështet pa rezerva hapjen e negociatave me BE-në", ka deklaruar komisionari evropian Günther Oettinger.

Lajmi konfirmohet nga Besnik Kelmendi, i cili prej më shumë se 25 vjetësh jeton në Gjermani dhe sot është një nga zërat më të dëgjuar në forcën politike më të madhe në Gjermani, CDU. Si zyrtar në Ministrinë e Brendshme të landit të Rajnës Veriore dhe Vestfalisë (NRW), Kelmendi është mjaft aktiv në përfshirjen dhe integrimin e

bashkatdhetarëve. Së fundmi, Kelmendi është bërë pjesë e takimeve të fushatës parazgjedhore në Gjermani për zgjedhjet për Parlamentin Evropian që do të mbahen gjatë këtij muaj, duke filluar nga data 23 deri më 26 maj 2019.

Në një prononcim për ATSh, Kelmendi tha se komisionari evropian Günther Oettinger konfirmoi mbështetjen e plotë të Gjermanisë lidhur me hapjen e negociatave të Shqipërisë. Po sipas tij, Oettinger tha se Gjermania e përkrah edhe Kosovën për liberalizimin e

vizave. "Në vazhden e kësaj fushate, në qytetin e Essenit u zhvillua një aktivitet parazgjedhor i Unionit Kristiandemokrat të kancelares Angela Merkel në mbështetje të kandidaturës së Dennis Rathkes për deputet të Parlamentit Evropian. Komisionari evropian për Planifikimin Financiar dhe Buxhet, Günther Oettinger (CDU), foli për sfidat e ardhshme të Bashkimit Evropian dhe për rëndësinë e një CDU/CSU-je të fortë pas 26 majit. Ai e vuri theksin te çështjet e sigurisë dhe domoshmëria e krijimit të një ushtrie



evropiane, sepse amerikanët nuk mund të mbeten përgjithmonë përgjegjës për sigurinë tonë në

Evropë", shprehet Kelmendi për ATSh duke bërë me dije detaje nga ky takim.

Nisin formalisht procedurat për formimin e tribunalit ndërkombëtar për krimet serbe në Kosovë



Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka nisur të hënën edhe formalisht procedurat për iniciativën për formimin e tribunalit ndërkombëtar për krimet që Serbia ka kryer gjatë luftës në Kosovë. Duke folur para përfaqësuesve të shoqatave të të pagjeturve, organizatave të dala nga lufta, institucioneve të drejtësisë dhe institucioneve tjera të pavarura, ai ka thënë se kriminelët serbë ende nuk janë gjykuar për mijëra krime dhe viktima në Kosovë

**EPOKA
ERE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 6 MAJ - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka nisur të hënën edhe formalisht procedurat për iniciativën për formimin e tribunalit ndërkombëtar për krimet që Serbia i ka kryer gjatë luftës në Kosovë. Duke folur para përfaqësuesve të shoqatave të pagjeturve, organizatave të dala nga lufta, institucioneve të drejtësisë dhe institucioneve tjera të pavarura, Veseli ka thënë se kriminelët serbë ende nuk janë gjykuar për mijëra krime dhe viktima në Kosovë. Sipas tij, ky tribunal do të jetë i ndarë nga Gjykata Speciale. "Po flasim për një gjykatë ndërkombëtare për krimet e shtetit serb, të paanshme, të domosdoshme. Një gjykatë ndërkombëtare e cila do t'i gjykojë dhe dënojë krimet e kryera nga shteti i Serbisë gjatë

luftës në Kosovë. Këto krime arrijnë përmasat e gjenocidit. Janë qindra masakra të kryera nga ushtria serbe. Janë dhjetëra mijëra civilë të vrarë, në mesin e tyre fëmijë dhe gra. Janë mijëra femra të dhunuara dhe një milion shqiptarë të dëbuar nga Kosova, në një përndjekje të ngjashme me Holokaustin e hebrejve", ka thënë Veseli, duke shtuar se edhe 20 vjet pas luftës, për këto masakra dhe krime nuk ka drejtësi. "Sepse Tribunali i Hagës e ka lënë të papërfunduar drejtësinë për masakrat e Serbisë në Kosovë. Po ashtu, drejtësia ndërkombëtare në Kosovë ka dështuar krejtësisht. Për fat të keq, edhe ne vetë si Kosovë nuk kemi bërë sa duhet - për sa i përket dokumentimit të të dhënave dhe dëshmitarëve", ka thënë Kryeparlamentari Veseli. Ai ka nxjerrë në pah një statistikë zyrtare, tronditëse. "Deri më tash për krimet e luftës në Kosovë

janë dhënë 189 vjet dënime për shqiptarët, ndërsa vetëm 29 vjet dënime për serbët. Kush ishte agresori këtu? Sikurse vë në dukje profesor Paul Williams, në dëshminë e tij të para disa ditësh në Kongresin Amerikan, Serbia nuk ka pasur vullnet politik, nuk ka dhënë burimet e duhura dhe mekanizmat e duhur për mbrojtjen e dëshmitarëve për krimet e luftës të kryera nga Serbia. Sipas tij, deri në vitin 2018 Serbia për të gjitha krimet e kryera në Bosnje, Kroaci dhe Kosovë ka marrë vetëm 44 vendime dhe ka dënuar vetëm 74 kriminelë. Ndërkohë që vetëm disa prej këtyre vendimeve kanë të bëjnë me Kosovën", ka thënë ai. Sipas Veselit, kjo gjykatë do të ngrihet jo mbi urrejtje, pretendime, por mbi fakte. "Mesazhi ynë është i qartë: Kosova po kërkon drejtësi për njerëzit e saj të vrarë, të masakruar e të dhunuar. Nuk pranon heshtje, as mohim. Dhe kjo drejtësi do të ndodhë. Serbia do të përgjigjet për këto viktima. Mesazhi ynë për kriminelët, mohuesit e krimeve, qyqarët, që sot enden të lirë nëpër Serbi, po ashtu është i drejtpërdrejtë: Do t'ju zëmë të gjithëve dhe do t'ju vëmë në pranga. Keni kryer krime, sepse jeni qyqarë. Keni pasur frikë të përbaleni me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, e keni sulmuar popullatën civile. Do të na keni prapa... edhe në gjumë", ka thënë Veseli.

Ministri i Drejtësisë, Aberlard Tahiri, ka theksuar se ministria që ai drejton dhe ekzekutivi i vendit do ta mbështesin nismën e Veselit, por ka shtuar se Ligji i ri i procedurës penale në Kosovë e mundëson që të gjykohej edhe personat që mungojnë. "Do të jemi përkrah jush dhe do të angazhohemi në tërësi për implementimin e kësaj iniciative. Kjo është një iniciativë e cila njëherë do të na i shërojë plagët që ende i kemi të pashëruara tani e 20 vjet pas luftës", ka deklaruar Tahiri.

Në këtë takim ka folur edhe kryetarja e Shoqatës "Thirrjet e nënave" nga Gjakova, Nysrete Kumnova, e cila ka kërkuar nga përfaqësuesit e institucioneve të vazhdojnë të jenë me familjarët e të vrarëve dhe t'ua kthejnë më të dashurit e tyre. "Jemi të provokuar edhe në komunën tonë në Gjakovë, kur vijnë serbët dhe lëvizin atje. Ata mbajnë pozita në Serbi dhe vijnë na përbuzin dhe na provokojnë. Nuk di a ka diku në botë ndonjë vend kur arrestohen nënat në vend se të arrestohen kryesit e veprave. Kjo iniciativë, edhe pse me vonesë, duhet të realizohet, që kriminelët të mos të bredhin të lirë", ka deklaruar Kumnova.

Bajram Qerkini, kryetar i Këshillit Koordinues të Asociacioneve të Familjarëve të Personave të Pagjetur, i cili tash e 20 vjet është në kërkim të djalit të vet të pagje-

tur, e ka përshëndetur nismën e Veselit, duke thënë se drejtësia duhet të kërkohej. "Drejtësia nënkupton as më shumë e as më pak sesa dënimin e shtetit të Serbisë dhe gjenocidin që e ka bërë. Për neve është e rëndësishme që të dënohet shteti i Serbisë e jo ndonjë individ për shkak se krimet i kanë kryer policia dhe ushtria, në mënyrë të organizuar", ka thënë Qerkini. Ndërkaq deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje, Saranda Bogujevci, ka deklaruar se për këtë iniciativë Kosovën duhet ta mbështesë dikush. "Një tribunal ndërkombëtar duhet të financohet nga dikush, nuk kemi kompetenca. Dhe kjo më bën skeptike për këtë tribunal. Kam mësuar se duhet t'i kryesh detyrat tua për ta mundësuar drejtësinë. Ka shumë gjëra që duhet t'i ndërtojmë brenda vendit. Unë nuk jam për tribunal ndërkombëtar. Jam për një gjykatë brenda Kosovës", ka thënë Bogujevci.

Kuvendi i Kosovës, në mesin e muajit prill, ka formuar një komision të veçantë 'ad hoc' për dënimin e krimeve të luftës, gjenocidit dhe agresionit të regjimit të Serbisë, i cili komision po punon për hartimin e rezolutës lidhur me këtë çështje. Qëllimi përfundimtar, siç kanë thënë më parë zyrtarët e Kuvendit të Kosovës, është hapja e tribunalit ndërkombëtar për krimet që Serbia i ka kryer në Kosovë.

Flet për "Epokën e re", Agim Bahtiri

Qeveria duhet të



Nënkryetari i Aleancës Kosova e Re (AKR), njëherësh kryetar i Komunës së Mitrovicës së Jugut, Agim Bahtiri, ka kritikuar qeverisjen e deritanishme të koalicionit PAN. Ai ka thënë se ky koalicion po qeveris në mënyrë çoroditëse meqë nuk ka platformë të përbashkët për t'i çuar proceset përpara. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Bahtiri ka deklaruar se një qeveri e cila nuk ka koncept dhe vizion nuk mund të ketë sukses. Prandaj, ai ka vlerësuar se qeveria aktuale duhet të japë dorëheqje. Bahtiri ka folur edhe për zgjedhjet në AKR, duke iu bërë thirrje qytetarëve që t'i bashkohen këtij procesi për të mirën e vendit. Ai i ka falënderuar qytetarët e Mitrovicës për mbështetjen që i kanë dhënë për t'u rizgjedhur kryetar i AKR-së në këtë komunë

do ta ngrëh zërin. Dal edhe jashtë kornizave, programit dhe statutit të partisë sime për ta luftuar të keqën, pavarësisht nëse vjen nga anëtarët e partisë sime apo nga dikush tjetër. Do të vazhdoj të kontribuoj për Kosovën dhe të luftoj të keqen që i vjen këtij vendi nga kushdo qoftë.

"Epoka e re": Edhe për një mandat do t'i qëndroni besnik AKR-së?

Bahtiri: Pavarësisht asaj që AKR-ja është pjesë e Qeverisë së Kosovës, unë do ta luftoj me çdo kusht të keqen. Askush nuk mund të më kushtëzojë që të jem në parti dhe të mos e ngrë zërin kundër së keqes. Kështu që çdo zë i ngritur për ndaljen e së keqes së këtij vendi, pavarësisht se nga

EPOKA E RE **Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 6 MAJ - **"Epoka e re":** Z. Bahtiri, të dielën jeni rizgjedhur kryetar i Degës së Aleancës Kosova e Re (AKR) në Mitrovicë. Si ishte ky proces dhe çfarë do të thotë për ju marrja e këtij mandati?
Bahtiri: Kryesia e AKR-së dhe

presidenti Pacolli më kanë shtyrë të kandidoj përsëri sepse kisha dilemë nëse duhet të kandidoj apo jo meqenëse familja ime është jashtë vendit. Mirëpo dëshira e tyre ishte që t'i hyj kësaj gare dhe të jem sërish kryetar i AKR-së në Mitrovicë. Procesin zgjedhor e kam pritur me kënaqësi të madhe sepse në historinë e të

gjitha partive politike në Mitrovicë nuk ka ndodhur mbledhja e 500 delegatëve për të zgjedhur një kryetar pa konkurrencë. Kjo më bën të ndihem mirë dhe qytetarët e kanë kuptuar se jam njeriu i duhur i tyre. Besimi dhe mbështetja e qytetarëve më mbajnë gjallë dhe më mbajnë në Kosovë.

"Epoka e re": Rizgjedhja juaj në krye të AKR-së ka hequr përfundimisht dilemat se ju nuk do ta braktisni AKR-në dhe të shkoni në Lëvizjen Vetëvendosje ashtu siç është përfolur në opinion?

Bahtiri: Jam kthyer në Kosovë për t'i ndihmuar popullit dhe vendit tim pavarësisht prej partive politike. Për çdo cent të keqpërdorur

japë dorëheqje

Mitrovicës dhe për disa herë me radhë kemi dalë komuna më transparente. Jam bërë kryetar për ta zhdukur të keqën dhe për t'i dhënë frymë të mirë këtij vendi. Pavarësisht se nga vjen iniciativa kundër hajnisë, unë do ta përkrah.

"Epoka e re": Duke i pasur parasysh zhvillimet në terren, jeni i kënaqur me gjendjen e AKR-së në përgjithësi?

Bahtiri: AKR-ja në Mitrovicë është shumë e fuqishme dhe do të jetë sërish partia e parë. Këtë e konfirmoi edhe konventa zgjedhore ku pati një interesim të madh sidomos nga të rinjtë. AKR-ja aktualisht është duke iu nënshtruar procesit të brendshëm zgjedhor dhe Mitrovica është komuna e parë që i ka kryer zgjedhjet. Tani duhet ta shohim ecurinë e procesit zgjedhor në komunat e tjera. U bëj thirrje të gjithëve që të bashkohemi në këtë proces për të mirën e vendit. AKR-ja është e gatshme për t'i pranuar gjeneratat e reja, intelektualët dhe njerëzit që e duan vendin.

"Epoka e re": Kur do të përfundoj procesi zgjedhor dhe si e shihni AKR-në pas zgjedhjeve?

Bahtiri: Nuk e di se kur do të përfundoj procesi meqë secila komunë veç e veç do t'i shpallë zgjedhjet e brendshme. Për shkak të punëve në komunë nuk kam pasur mundësi të angazhohem shumë në parti. Komuna e Mitrovicës është komuna më problematike jo vetëm në Kosovë, por edhe në Ballkan. Prandaj, nuk kam pasur kohë të merrem shumë me parti, por do të angazhohem në të ardhmen për të bërë më të mirën për AKR-në dhe për Kosovën.

"Epoka e re": Si e komentoni rolin e AKR-së në qeverisjen e nivelit qendror?

Bahtiri: Njerëzit e AKR-së deri më tani nuk kanë keqpërdorur asnjë cent dhe nga kjo duhet të marrin mësim edhe të tjerët se si qeverisin ministrat tanë. Z. Pacolli dhe unë nuk kemi ardhur për të përfituar nga politika, por kemi humbur shumë. Kemi fituar besueshmëri dhe mbështetje për t'i kontribuar vendit. Puna jonë me duar të pastra duhet të jetë shembull për të tjerët që të na bashkohen për t'i çuar proceset përpara. Shteti i Kosovës ka nevojë për njerëz me duar të pastra dhe që e duan vendin.

"Epoka e re": Z. Bahtiri, çfarë vlerësimi keni në përgjithësi për qeverisjen e deritanishme të koalicionit PAN?

Bahtiri: Mendoj se është

jashtëzakonisht e keqe. Është një qeverisje çoroditëse për arsye se nuk ka platformë për t'i çuar proceset përpara. Secila parti e ka në plan për të përfituar sa më shumë për veti dhe nuk ka koordinim për t'i lëvizur përpara proceset. Unë mendoj se kjo qeveri duhet të shkojë sa më shpejt në shtëpi.

"Epoka e re": Edhe pse janë bashkë në pushtet, sipas jush, AKR-ja po qeveris mirë, por partitë e tjera në koalicion po qeverisin keq.

Bahtiri: Një qeveri e cila nuk ka një koncept dhe vizion të përbashkët asnjëherë nuk ka arritur sukses. Samiti i Berlinit shpërfaqti mosbashkëpunimin e partive në pushtet. Kjo është për të ardhur keq, prandaj kjo qeveri duhet t'i kthehet normalitetit dhe të shikojë se ku ka arritur dhe të japë dorëheqje.

"Epoka e re": Kur do ta ketë fundin ky koalicion qeverisës?

Bahtiri: Koalicioni qeverisës është duke u varur nga PDK-ja. Kësaj partie i ka ardhur fundi dhe nuk mund t'i fitojë zgjedhjeve

dhe të jetë pjesë e qeverisë së re. Kjo qeverisje po shtyhet për këtë qëllim e jo për gjëra të tjera. Në të kundërtën, në momentin që PDK-ja do ta kishte kuptuar se do të mund të jetë pjesë e pushtetit përsëri, sigurisht se do ta kishte prishur qysh moti koalicionin. Është e habitshme se si tani ngrehët zëri për krijimin e një tribunali për krimet serbe gjatë luftës në Kosovë. Pse deri më tani nuk është bërë një gjë e tillë? Cila ka qenë arsyeja që për 20 vjet nuk kanë kërkuar të krijohen mekanizmat për zbardhjen e krimeve serbe në Kosovë? Tash kur do të shkojnë në Hagë ngrehin teza. Kjo është e keqja e këtij vendi. Plani paska qenë që të barazohet lufta në mes të Serbisë që ka bërë krime në Kosovë dhe lirishtesve tanë të cilët kanë luftuar për t'i dalë zot atdheut dhe për ta mbrojtur popullin.

"Epoka e re": Kryetar, çfarë është duke ndodhur me iniciativën për bashkimin e Mitrovicës?

Bahtiri: Qëllimi im është i qartë për arsye se qytetarët e Mitrovicës të pjesës së veriut ende nuk e kanë gëzuar lirinë

dhe sovranitetin e Kosovës. Ata nuk kanë lëvizje të lirë dhe çdoherë e shohin qytetin dhe pronën e tyre si të huaj nga pjesa e jugut. Nuk ka më vështirë sesa të jesh refugjat në qytetin tuaj. Kjo më ka shtyrë ta marr iniciativën për bashkimin e Mitrovicës sepse është ndarë padrejtësisht dhe dihet se kush e ka bërë këtë ndarje. Dëshira e qytetarëve, pavarësisht prej kombësisë që i takojnë, është të bashkohet Mitrovica. Veriu udhëhiqet nga grupet kriminale dhe ka pasur përpjekje për mbledhjen e serbëve nga ish-Jugosllavia për t'i sjellë në veri në mënyrë që të ndryshohet numri i popullsisë. Kurse shqiptarët nuk lejohen të shkojnë në pronat e veta në veri dhe qeveria nuk ka bërë asgjë për ta. Plani ka qenë i përcaktuar por, fatbardhësisht, e kemi kuptuar me kohë dhe e kemi parandaluar. Plani i Hashim Thaçit është varrosur njëherë e përgjithmonë. Plani për shkëmbimin e territoreve ka qenë i fuqishëm, është investuar shumë, por e kam ngritur zërin te vendorët dhe te ndërkombëtarët për të pamundësuar realizimin e tij.



Uran Ismaili, kandidat për kryetar të Degës së PDK-së në Prishtinë

PRISHTINË, 6 MAJ (ER) - Uran Ismaili ka zyrtarizuar të hënën kandidaturën për kryetar të Degës së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Prishtinë. "Pas një pune të madhe lagje për lagje dhe fshat për fshat, sot edhe zyrtarisht dorëzoja kandidaturën time për kryetar të Degës së PDK-së në Prishtinë. Duke synuar një Prishtinë më të mirë, kam

vendosur që angazhimin tim politik e partiak ta përqendroj në qytetin tim", ka shkruar ai në llogarinë e vet në "Facebook". Ismaili ka thënë se energjinë e Dekadës së Re synon ta shndërrtojë në një forcë që e transformon marrëdhënien në mes të PDK-së dhe Prishtinës, që PDK-së i jep një identitet të ri, kurse Prishtinës vëmendjen

që e meriton. "Prishtina nuk duhet të jetë vetëm kryeqytet ku përqendrohet jeta politike e Republikës, por edhe qytet i jetueshëm për qytetarët e saj. Përvojat tona negative me qeverisjet e kaluara le t'i përkthejmë në përpjekje të përbashkët pozitive për Prishtinën tonë. Është koha që vizioni për një Prishtinë funksionale të bëhet realitet", ka thënë Ismaili.

cili subjekt politik vjen, unë do ta përkrah sepse e dua këtë vend dhe do të bëjë gjithçka për të mirën e tij. Nuk më intereson fare nga vjen iniciativa. Do të angazhohem për të mirën e popullit dhe do ta ngreh zërin për ta kundërshtuar të keqën.

"Epoka e re": Pse po merrni pjesë në tubimet e organizuara nga Lëvizja Vetëvendosje kundër 'PANhajnisë' përderisa AKR-ja është pjesë e këtij koalicioni?

Bahtiri: Jam kundër 'PANhajnisë' deri në fund pavarësisht se AKR-ja është pjesë e koalicionit. Hajnat duhet të dalin në shesh dhe ata duhet t'i luftojmë të gjithë. Unë nuk e përkrahi hajninë, prandaj publikisht kam dalë kundër. Në vazhdimësi kam luftuar për ta hequr hajninë nga Komuna e

Veseli dhe Haradinaj pritën në takim përfaqësuesit e partive opozitare nga Shqipëria

**EPOKA
ERE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 6 MAJ - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, dhe kryeministri Ramush Haradinaj kanë pritur të hënën në takim të ndara një delegacion të disa partive opozitare në Shqipëri, të kryesuar nga Fatmir Mediu, kryetar i Partisë Republikane, Agron Duka, Nard Ndoka dhe Vangjel Dule.

Kryeparlamentari Veseli dhe përfaqësuesit politikë nga Tirana diskutuan për zhvillimet politike

në Kosovë dhe Shqipëri, për sfidat me të cilat po përballen të dyja vendet në proceset zhvillimore e euro-integruese, si dhe për avancimin e marrëdhënieve të mëtejme midis dy vendeve. Bashkëbiseduesit shtruan nevojën e një bashkëpunimi më të thellë në të gjitha fushat dhe në kapërcimin e sfidave të përbashkëta në rrugën e integritimit euroatlantike.

Gjatë takimit u shkëmbyen informacione dhe ide për zhvillimet e përgjithshme politike dhe ekonomike në Shqipëri dhe



Kosovë.

Kryeparlamentari Veseli, pasi shprehu mirënjohje për mbështetjen e dhënë nga Shqipëria ndër vite, tha se e ardhmja e përbashkët e të dy vendeve është në Bashkimin Evropian. Përfaqësuesit e partive opozitare nga Shqipëria e falënderuan kryeparlamentarin Veseli për mirëpritjen dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm me të gjitha forcat politike shqiptare.

Ndërkaq kryeministri Haradinaj i ka falënderuar të pranishmit për vizitën në Kosovë, duke i njoftuar ata për përparimin që ka bërë vendi në fusha të rëndësishme dhe jetike për qytetarët e Kosovës. "Bashkëpunimi ndërmjet spektrit politik të Kosovës me atë të Shqipërisë në të gjitha periudhat ka qenë i frytshëm pavarësisht prej orientimeve partiake. U jemi mirënjohës për mbështetjen e vazhdueshme që Shqipëria ka dhënë për Kosovën në çdo etapë

të zhvillimit të saj", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke shtuar se tani është me rëndësi bashkërendimi i aktiviteteve të përbashkëta që forcojnë edhe më shumë marrëdhëniet tona.

Delegacioni i partive opozitare nga Republika e Shqipërisë, i kryesuar nga Fatmir Mediu, kryetar i Partisë Republikane, e falënderoi kryeministrin Haradinaj për mikpritjen, duke shtuar se Shqipëria do të jetë gjithmonë përkrahëse e fuqishme e shtetit të Kosovës.



Gjenerali Orr, portret i mbështetjes amerikane për FSK-në

PRISHTINË, 6 MAJ (ER) - Në Ministrinë e Mbrojtjes zëvendësministri Burim Ramadani dhe komandanti i FSK-së, gjeneraljtënant Rrahman Rama, kanë pritur të hënën në takime të ndara gjeneralmajorin Timothy E. Orr, komandant i Gardës Kombëtare të Ajovës nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në takimin e zëvendësministrit

Ramadani me gjeneralin Orr u diskutua për arritjet e Kosovës në themelimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe mandatin ushtarak të FSK-së, po ashtu për planet e Ministrisë së Mbrojtjes për periudhën e ardhshme në zhvillimin dhe modernizimin e FSK-së.

Gjenerali Orr u njoftua për zhvillimet e përgjithshme në Kosovë,

për gatishmërinë e Kosovës për të dhënë kontribut për sigurinë kudo në botë krahas përkrah me trupat amerikane dhe të NATO-s. Në këtë takim është theksuar se Kosova është plotësisht e përkushtuar për thellimin e marrëdhënieve të përgjithshme me ShBA-në në të gjitha fushat, duke marrë shembull marrëdhëniet në fushën e mbrojtjes.



Kryesia e LDK-së bën homazhe te varri i Fehmi Aganit

PRISHTINË, 6 MAJ (ER) - Në 20-vjetorin e vrasjes së heroit të Kosovës, Fehmi Agani, Kryesia e LDK-së ka bërë homazhe dhe ka vendosur kurora me lule te varri i tij. Në emër të Kryesisë së LDK-së ka folur sekretari i përgjithshëm, Ismet Beqiri, i cili ka vlerësuar lart figurën e veprimtarit Fehmi Agani.

"Akademik Fehmi Agani ishte i zgjuar dhe intelektual i cili u vra nga dora kriminale serbe. Ai ishte bashkëpunëtor i presidentit historik dr. Ibrahim Rugova. Tërë jetën ia kushtoi shtetformimit të Kosovës. Mungesa e tij vërehet nëpër institucionet tona. Ka lënë gjurmë të thella", ka thënë Beqiri.

Aki Nuredini dekorohet me Medalje Presidenciale nga Hashim Thaçi

PRISHTINË, 6 MAJ (ER) - Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, e ka dekoruar me Medalje Presidenciale Aki Nuredinin, i cili njihet për kontributin e

dhënë në çështjen kombëtare dhe pavarësinë e Kosovës. "I jemi mirënjohës për strehimin dhe përkrahjen që ua ka dhënë të gjithë aktivistëve tanë që

kanë kaluar nëpër Vjenë, në këto tri dekadat e fundit. Atij i kërkova të vazhdojë të angazhohet, sikurse edhe në të kaluarën, për promovimin e

Kosovës në skenën ndërkombëtare, veçanërisht në fushën e artit dhe të kulturës", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".



Në 22-vjetorin e rënies heroike është përkujtuar Luan Haradinaj

Heroi Luan Haradinaj ishte bërthama e parë e UÇK-së

Me rastin e 22-vjetorit të rënies së heroit Luan Haradinaj, kryeministri Ramush Haradinaj, zëvendëskryeministri Fatmir Limaj, ministra, deputetë, kryetarë komunash, familjarë të dëshmorëve dhe qytetarë të shumtë, kanë bërë homazhe në Deçan dhe Gllogjan. Zëvendëskryeministri Fatmir Limaj ka thënë se gjeneral Luan Haradinaj ka qenë bërthama e parë e UÇK-së. "Me luftën dhe veprën e tij ai ka motivuar qindra mijëra ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës", ka thënë Limaj



Shala në emër të Thaçit ndan urdhrin "Hero i Kosovës" për Smajl Haradinajn

Nënkryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Migjen Shala, në emër të presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, ka ndarë të hënën urdhrin "Hero i Kosovës" për Smajl Haradinajn. Shala këtë dekoratë ia ka dorëzuar Nasim Haradinajt.

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

GLLOGJAN, 6 MAJ - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, mori pjesë në shënimin e 22-vjetorit të rënies së heroit të Kosovës, gjeneralmajor Luan Haradinaj. Fillimisht, kryeministri Haradinaj bëri homazhe te shtatoret e heronjve Luan Haradinaj e Salih Çekaj në Deçan si dhe në Kompleksin Memorial "Dëshmorët e Kombit" në Gllogjan. Kryeministri Haradinaj me këtë

rast ka thënë se janë bashkuar për të përkujtuar bacën Smajl, një atdhetar të shquar shqiptar, vazhdues i një trangu vërtet atdhetar, prej Xhemajl Haradinajt e deri te paraardhësit e tjerë, që në luftërat për liri, për komb e atdhe, kanë qenë gjithmonë të pathyeshëm. "Fjala i pathyeshëm është një fjalë që mund ta thuash kohë pas kohe në raste të caktuara dhe ju siguroj se nga moshë që e kam njohur, kur unë kam qenë fëmijë, Smajl Haradinaj ka qenë i pathyeshëm", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke shtuar se nëse dikujt duhet

t'i atribuohet pathyeshmëria në bindje e në ideale të veta të lirisë e të kombit, atëherë të gjithë mendojnë se ai ka qenë i pathyeshëm. Haradinaj theksoi se vepra dhe rruga e tij jetësore kanë qenë jo vetëm frymëzim për breza të tjerë dhe, kësaj, ka ardhur deri te brezi i fundit i luftëtarëve shqiptarë të lirisë, i brezit të UÇK-së. "Luani ka

pasur nderin me qenë bashkëluftëtar i plot bashkëluftëtarëve të gjallë që takoj sot këtu, por edhe me plot dëshmorë, martirë e heronj që i njohim. Ai ka rënë më 6 maj 1997. Ai ishte ndër të parët që e refuzoi kufirin shqiptaro-shqiptar të na ndajë dhe të cilin e ka kaluar sikur të kalonte nëpër tokën e vet, duke

mos e përfillur atë ndarje. Rënia e tij në atë kufi është porosi që nuk do të lejojmë ndarje mes neve, mes shqiptarëve", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke shtuar se do të nderohet sot e përjetë vepra e atdhetarëve shqiptarë, jo vetëm e bacës Smajl dhe e brezit të tij, i cili në atë kohë guxoi të besojë se mund ta kundërshtojë Jugosllavinë, por edhe brezin e UÇK-së, i cili do të nderohet me punë.

Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka thënë se dëshmorët që kujtojmë sot, por edhe të gjithë të rënë për liri, janë emra të lavdishëm të historisë së kombit, emra titanësh, që përjetë do të mbesin model se si duhet atdheu.

Të pranishëm në shënimin e këtij përvjetori ishin edhe ministra, deputetë, kryetarë komunash, familjarë të dëshmorëve dhe qytetarë të shumtë.



Limaj bën homazhe te heroit Luan Haradinaj, thotë se ishte bërthama e parë e UÇK-së

Edhe zëvendëskryeministri i Kosovës, njëherësh kryetar i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka bërë të hënën homazhe me rastin e 22-vjetorit të rënies heroike të Luan Haradinajt. Limaj ka thënë se gjeneral Luan Haradinaj ka qenë bërthama e parë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. "Me luftën dhe veprën e tij ai ka motivuar qindra mijëra ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Veprat dhe sakrificat e Luanit dhe dëshmorëve të tjerë të UÇK-së janë gurthemeli i lirisë së Kosovës. Dita e sotme përkon edhe me ditëlindjen e një prej patriotëve të shquar të Kombit, Ismail Haradinaj. Lavdi dëshmorëve të Kombit!", ka thënë Limaj.

Kryhet një operacion i rrallë te një fëmijë në QKUK

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 6 MAJ - Një ekip mjekësor në Klinikën e Kirurgjisë së Fëmijëve ka kryer me sukses një operacion të rrallë te një fëmijë i moshës dyvjeçare, i dyti që realizohet brenda 20 vjetëve në QKUK. Fëmija kishte marrë lëndime në bark nga një televizor dhe, pas ekzaminimeve të nevojshme, mjekët kanë vërejtur një formacion cistik në pankreas. Kirurgu Ali Aliu ka treguar se intervenimi është kryer me sukses të plotë, ndonëse i komplikuar, kurse pacienti është

lëshuar për në shtëpi. "Pas intervenimit me sukses, pacientja është liruar brenda javës për në shtëpi. Në pranim pacientja kishte 10.5 kilogramë. Këto raste janë të rralla, kanë qenë edhe më herët. Për fat të mirë, këto raste kryhen në klinikën tonë dhe nuk ka nevojë për trajtim jashtë vendit", ka thënë Aliu.

Për ta parandaluar përkeqësimin e gjendjes shëndetësore, mjekët ia kishin ndërprerë mënyrën e rregullt të të ushqyerit dhe pacientja ishte mbajtur vetëm me terapi parenterale (infuzion). Drejtori i Klinikës së Kirurgjisë së Fëmijëve, Murat Berisha, ka pohuar se fëmija ka qëndruar pa

ngrënë më shumë se një muaj meqë ishte konstatim i mjekëve për t'i shmangur komplikimet e tjera. "Është rast i ndjeshëm. Pas traumës që pëson pacienti, duhet të qëndrojmë pa ushqim. Fëmija ka qëndruar pa ngrënë pesë javë. Është mbajtur me një material ushqyes që kushton shumë, por familjarët nuk kanë pasur nevojë të shpenzojnë për të, sepse ne si Klinikë e kemi", ka deklaruar Berisha.

Durim Kastrati, babai i pacientes, është shprehur i kënaqur me mënyrën e trajtimit të vajzës dhe ka falënderuar mjekët për punën e bërë. "Nuk kam menduar që mjekët tanë



mund t'i kryejnë këto operacione. Sjellja e tyre ka qenë shumë e mirë. Për secilin veprim na kanë informuar. Rasti, sipas

mjekëve, ka qenë i rëndë, por është kryer me sukses. Shërbimi për vajzën time ka qenë shumë i mirë", ka thënë ai.

Ujësjetlësi 'Prishtina': Uji, 100 për qind i sigurt

Kompania Rajonale e Ujësjetlësit "Prishtina" ka njoftuar se cilësia e ujit është e kontrolluar dhe testuar me analiza fiziko-kimike dhe bakteriologjike sipas parametrave të cilët janë në Listën A dhe C në Udhëzimin Administrativ për cilësinë e ujit për konsum nga njeriu. Sipas kësaj kompanie, uji i cili u ofrohet qytetarëve është 100 për qind i sigurt



EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINE, 6 MAJ - Kompania Rajonale e Ujësjetlësit "Prishtina" sh. a. ka njoftuar se uji i cili u ofrohet qytetarëve është i 100 për qind i sigurt për pije. Sipas njoftimit për media të kësaj kompanie, qëllimi kryesor i Departamentit të Cilësisë së Ujit të pijshëm në Kompaninë Rajonale të Ujësjetlësit "Prishtina" sh. a. është organizimi dhe funksionimi i tij si departament për kontrollin e kualitetit të ujit, bazuar në standardet cilësore aplikative dhe ato evropiane mbi kualitetin e ujit për përdorim nga njerëzit. Sipas Kompanisë Rajonale të Ujësjetlësit "Prishtina", kjo direktivë përcakton dallimet në mes të parametrave mikrobiologjikë dhe atyre fiziko-kimikë. "Aplikimi i standardeve është në interes të të gjithë konsumatorëve të Prishtinës, Fushë-

Kosovës, Obiliqit, Shtimes, Lipjanit, Podujevës, Drenasit, Graçanicës dhe Fabrikës së trajtimit të ujit në Shkabaj. Departamenti i Cilësisë së Ujit, me planin e monitorimit të brendshëm, ka në procedurë pikë së pari mbledhjen dhe marrjen e mostrave të ujit të përpunuar nga rrjeti i ujësjetlësit, aeratorëve, liqeneve, puseve dhe lumenjve. Laboratorët tanë të cilët janë të akredituar shfrytëzojnë metoda standarde për parametrat të cilat janë të aprovuara nga BE-ja, sipas procedurës të cilat janë dhënë me Direktivën 98 (93) EC", është theksuar në njoftimin për media të kësaj kompanie.

Sipas planit ditor, javor dhe mujor për monitorimin e brendshëm të kualitetit të ujit në KRU "Prishtina" sh. a., të burimeve sipërfaqësore Albanik, Badoc, Bivolak, Mihaliq (Kanali Ibër - Lepencit)

dhe burimeve nëntokësore Kroni, Obiliq, Shtime, Lipjan, Peran (Podujevë), Miradi, Graçanicë dhe Vragoli, si dhe pesëmbëdhjetë pikat në rrjetin e qytetit, në aplikim të monitorimit të shpejtë bazik dhe vijues përcillet kualiteti i ujit të pijshëm në çdo pikë mostrimi. KRU "Prishtina" ka njoftuar se cilësia e ujit është e kontrolluar dhe testuar me analiza fiziko-kimike dhe bakteriologjike sipas parametrave të cilët janë në listën A dhe C në Udhëzimin Administrativ Nr. 16/2012 për

cilësinë e ujit për konsum nga njeriu. "Numri i mostrave të ujit për pije për analizën fiziko-kimike në gjashtë muajt e ardhshëm supozohet të jetë afro 6 850 mostra të ujit. Një vëllim kaq i madh i punës dhe një kontroll ditor dhe periodik, bën që uji i pijshëm të jetë i sigurt 100 për qind. Me monitorim të shpejtë, bazik dhe vijues çdo ditë do të bëhet mostrimi dhe analiza e ujit që prodhohet dhe distribuohet nga fabrikat e ujit në Albanik, Badoc dhe Shkabaj (Ibër-Lepenc) nga objektet

prodhuese Kastriot dhe Kroni, pastaj monitorimi javor i ujit që prodhohet në objektet prodhuese Shtime, Lipjan, Drenas dhe Podujevë, si dhe analiza e ujit në tre rezervuarët në qytet. Numri i mostrave të ujit për pije për analizën fiziko-kimike në vitin 2019 planifikohet të jetë afro 13 650 mostra të ujit", është thënë në njoftimin e KRU "Prishtina". Paralelisht me laboratorin e akredituar të KRU "Prishtina" sh. a. analizat bëhen çdoherë edhe nga Instituti i Shëndetit Publik të Kosovës.

MBPZHR-ja, marrëveshje me shoqërinë civile për monitorimin e ndarjes së granteve



PRISHTINE, 6 MAJ (ER) - Këtë vit në procesin e vlerësimit të projekteve të fermerëve dhe agrobizneseve, të cilët aplikojnë për të përfituar grante investive në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, gjejmësisht në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, do të marrin pjesë edhe monitoruesit e Rrjetit Ballkanik për

Gazetari Hulumtuese (BIRN Kosova).

Për ta arritur marrëveshjen për këtë qëllim, të hënën ministria e MBPZHR-së, Dijana Ziviq, bashkë me sekretarin e përgjithshëm të ministrisë, Kapllan Halimi dhe kryeshefin e AZhB-së, Ekrem Gjokaj, kanë pritur në një takim përfaqësuesit e BIRN-it, të cilët kishin

parashtruar kërkesën për të marrë pjesë në procesin vlerësues të ndarjes së granteve investive.

Gjatë këtij takimi palët janë pajtuar të nënshkruhet një memorandum mirëkuptimi në mes të MBPZHR-së dhe BIRN-it, që monitoruesit e kësaj të fundit të marrin pjesë në të gjitha komisionet vlerësuese për

projektet e fermerëve dhe agrobizneseve, të cilët do të aplikojnë këtë vit për të përfituar grante investive në kuadër të Programit për Zhvillim Rural 2019.

Me këtë rast, ministria Ziviq ka theksuar se për implementimin e Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural i kanë ndërmarrë të gjitha masat që gjatë tërë

kohës të ketë një vlerësim të drejtë dhe transparent, duke përfshirë në këtë proces edhe shoqërinë civile.

Thirrjet për aplikim për Programin për Zhvillim Rural pritet të dalin gjatë këtyre ditëve, ndërkaq pas përfundimit të periudhës për aplikim fillon edhe procesi i vlerësimit të aplikacioneve nga AZhB-ja.

Haradinaj ofron përkrahjen e qeverisë për zgjidhjen e problemeve në Telekom

PRISHTINË, 6 MAJ (ER) - Kryeministri Ramush Haradinaj ka pritur të hënën në takim drejtorin ekzekutiv të Telekomit të Kosovës, Bedri Istrefi, me të cilin ka diskutuar për zhvillimet e fundit në këtë kompani dhe për obligimet financiare që ka kjo ndërmarrje, përfshirë këtu edhe kontratën me "Z Mobile". "Qeveria e vendit angazhohet për qëndrueshmërinë biznesore dhe financiare të Telekomit të Kosovës", ka thënë pas takimit kryeministri Ramush Haradinaj. Edhe drejtori ekzekutiv i Telekomit të Kosovës, Bedri Istrefi, ka treguar se me kryeministrin kanë biseduar për zhvil-

limet aktuale në Telekomin e Kosovës dhe stabilitetin financiar të këtij asemi shumë të rëndësishëm nacional. "E njoftova kryeministrin se sfidat me të cilat po ballafaqohet Telekom i Kosovës do të tejkalohen vetëm me përkrahje institucionale. Kryeministri Haradinaj, nga ana e tij, shprehu gatishmërinë për ofrimin e mbështetjes së parzervë në përpjekjet tona për ta gjetur zgjidhjen më adekuatë për të gjitha problemet e akumuluar ndërsa vite dhe për ta rikthyer Telekomin e Kosovës në pozitën e vet lidere në sektorin e telekomunikimit në vend", ka thënë Istrefi.



Ambasadori amerikan përkrah ndërtimin e termocentralit 'Kosova e Re'

PRISHTINË, 6 MAJ (ER) - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Philip Kosnett, ka thënë se është i lumtur që Qeveria e Kosovës ka përzgjedhur ofertuesin e preferuar për ndërtimin e termocentralit "Kosova e Re". "Krenar të shoh që një kompani lidere amerikane është e përfshirë në ndërtimin e termocentralit 'Kosova e Re'. Kjo shënon një hap kyç për një projekt që ne besojmë se është jetësor për sigurinë afatgjatë për energji për Kosovën. Urime të gjithëve!", ka shkruar në "Twitter" ambasadori Kosnett.

Ky projekt është paraparë të ketë vlerën 1.3 miliard dollarë. Financimi pritet të bëhet në bashkëpunim me kompaninë me bazë në Londër, Contour Global dhe një konsorciumi të

një prej filialeve të General Electric me bazë në ShBA, për të ndërtuar dhe pajisur një termocentral me qymyr me fuqi prej 500 megavatësh në Kosovë.

Ky projekt shënon një hap të rëndësishëm për ekonominë e Republikës së Kosovës dhe do ta përfaqësojë investimin e drejtpërdrejtë të huaj më të madh të bërë ndonjëherë në vend. Termocentrali do ta furnizojë ngarkesën bazë energjetike tejet të nevojshme me çmimin më të lirë të mundshëm dhe në mënyrë të besueshme për ta përmbushur kërkesën në rritje për energji elektrike në Kosovë në mënyrë të pavarur, pa u mbështetur në import.

Gjatë dekadës së fundit Republika e Kosovës ka importuar energji elektrike në vlerë mbi 500 milionë euro. Duke përdorur



teknologjinë më të fundit dhe burimet e bollshme vendore të lëndës djegëse, "Kosova e Re" do të jetë një nga termocentralet më bashkëkohore me qymyr në botë.

"Kosova e Re" do të jetë instrumentale për rritjen e cilësisë së jetës së njerëzve. Termocentrali do të rezultojë me përmirësimin e konsiderueshëm të cilësisë së

ajrit duke reduktuar emetimet e ndotësve kryesorë dhe do të kontribuojë në përmirësimin e shëndetit të njerëzve që jetojnë dhe punojnë në rajon.

Kryetari i OEK-ut: Kompanitë vendore rrisin punësimin rreth 13.3 për qind



PRISHTINË, 7 MAJ (ER) - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, ka thënë se bizneset vendore kanë tendencë që ta rrisin punësimin për 13.3 për qind krahasuar me tremujorin e fundit të vitit 2018. Këto komente ai i bëri me rastin e prezantimit të rezultateve të klimës të biznesit në Kosovë për tremujorin e parë të këtij viti.

Rukiqi ka theksuar se kjo tendencë për rritje të punësimit vjen si rezultat edhe i punëve sezonale. "465 biznese e vlerësojnë gjendjen e tyre të mirë dhe të kënaqshme. Nëse shikohet trendi, themi se është një trend pozitiv. Nëse i shohim rritjet për punësim, 44 për qind e kompanive presin që ta rrisin punësimin rreth 13.3 për qind më të lartë sesa në tremujorin e fundit të vitit 2018.

Edhe indikator i konfidencës ka shënuar trend pozitiv dhe është pjesë e mirë që mund të merret jo vetëm nga Oda Ekonomike, por edhe nga institucionet e tjera", ka thënë ai.

Rukiqi ka folur edhe për studimin që i është bërë eksportit, me ç'rast ka pohuar se, pavarësisht prej potencialit që kompanitë vendore kanë për eksport, ato nuk po mund të eksportojnë mjaftueshëm për shkak të barrierave të shumta me të cilat përballen çdo ditë. Sipas tij, mungesa e certifikimit ndërkombëtar del të jetë pengesa kryesore e këtyre kompanive. Rukiqi ka folur edhe për energjinë e ripërtëritë, ku ka bërë me dije se të mërkurën do të organizohet një takim me klubet e bizneseve me të cilat do të diskutohet për politikat mbi energjinë.



Malisheva përkujton dëshmorin Afrim Krasniqi - komandant 'Drenica'

MALISHEVË, 6 MAJ (ER) - Në Tërpezë të Malishevës është mbajtur një tubim përkujtimor kushtuar dëshmorit dhe heroit të kombit Afrim Krasniqi, i njohur si komandant "Drenica", i cili ka rënë heroikisht në betejën e Koshares më 6 maj të vitit 1999. Në këtë tubim përkujtimor, krahas familjarëve dhe qytetarëve të shumtë, kanë marrë pjesë edhe kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ministri i Ministrisë së Mbrojtjes, Rustem Berisha, deputeti i Kuvendit të Kosovës, Haxhi Shala, zëvendësministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme, Çerkin Dukolli, kryetari i Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve, Xhavit Jashari,



kryetari i OVLUÇK-së në Malishevë, Metush Kryeziu dhe personalitete të shumta. Në këtë tubim përkujtimor, në fjalët e tyre, ministri Berisha dhe kryetari Begaj kanë vlerësuar lart figurën dhe kontributin e komandant Drenicës. Po ashtu, Berisha dhe Begaj, duke iu refer-

uar debateve të fundit për betejën e Koshares, u kanë bërë thirrje të gjithëve që t'i lënë anash këto debate, pasi pikërisht ajo betejë është simbol i bashkimit, ndërsa edhe amaneti i dëshmorëve të rënë në atë betejë ishte bashkimi. Edhe Xhavit Jashari dhe Çerkin Dukolli kanë vlerësuar lart veprën e Afrim Krasniqit, ndërsa përkujtuan edhe betimin e ushtarit dhe amanetin e dëshmorëve për bashkim. Ndërsa Metush Kryeziu, në emër të OVL të UÇK-së, dega në Malishevë, përveç që ka folur për kontributin e dëshmorit dhe heroit Afrim Krasniqi, familjes ia ka dorëzuar edhe dekoratën e ndarë për komandant Drenicën.

Muharremaj: Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Buxhet në Therandë ka realizuar punë të suksesshme

THERANDË, 6 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Therandës, Bali Muharremaj, ka bërë me dije se Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Buxhet, në raportin katërmujor, në bazë të planifikimit të të hyrave, ka realizuar një punë të suksesshme. Ai ka thënë se në të gjitha kategoritë ku operon

drejtoria në fjalë ka tejkalim të planit, çka konsiderohet sukses i kësaj drejtorie. "Tatimi në pronë 103.18 për qind, tejkalim i planit; rentë dhe qira 122.62 për qind, tejkalim i planit dhe taksa në aktivitet 114.77 për qind, tejkalim i planit", ka thënë kryetari Muharremaj.



Në Mitrovicë zbulohet shtatorja e dëshmorit të kombit Artim Jashari

MITROVICË, 6 MAJ (ER) - Nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, të hënën është bërë zbulimi i shtatores së dëshmorit të kombit Artim Jashari, me rastin e 21-vjetorit të rënies së tij, te Sheshi "Artim Jashari" (afër stacionit të Autobusëve), në qytetin e Mitrovicës.

Në këtë manifestim ishin të pranishëm kryetari i komunës, Agim Bahtiri, ministri i Financave, Bedri Hamza, kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, nënkryetari i komunës, Faruk Mujka, pjesëtarë të FSK-së, pjesëtarë të Policisë së Kosovës, familjarë të dëshmorëve dhe vet-

eranëve të luftës, përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta si dhe shumë qytetarë të tjerë.

Në fjalën e tij kryetari i komunës, Agim Bahtiri, ka thënë se ndihet nderuar çdoherë kur organizohen tubime të tilla përkujtimore përmes të cilave kujtojmë kontributin e jashtëzakonshëm që kanë dhënë dëshmorët tanë në luftën dhe çlirimin e atdheut. Po ashtu, kryetari Bahtiri ka ftuar të gjitha institucionet qendrore dhe ato lokale që të bashkohen në mënyrë që të punojnë dhe t'i ndihmojnë këtij vendi dhe popullit të saj. Ndërsa ministri i Financave, Bedri Hamza, ka theksuar se asnjëherë dhe në asnjë rast nuk ka fjalë ekuiva-

lente që e përshkruan dhe e dëshmon veprën e heroit Artim Jashari, duke shtuar se si institucione është pak çfarë bëjnë në krahasim me veprat e dëshmorëve.

Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka thënë se është nderuar të jetë i pranishëm në këtë ngjarje për ta kujtuar veprën e Artimit. Në emër të familjarëve ka folur vëllai i dëshmorit, Kastrioti, i cili i ka falënderuar institucionet qendrore dhe ato lokale për mbështetjen e vazhdueshme ndaj familjes së tyre. Ai ka thënë se vlerat e luftës pa dyshim janë gurthemel i Kosovës dhe se përkushtimi ndaj tyre po ndodh edhe sot.



Nis projekti për ndërtimin e rrugës me katër korsi nga Rahoveci deri në Xërxë

RAHOVEC, 6 MAJ (ER) - Komuna e Rahovecit ka ndarë buxhetin për ndërtimin e rrugës me katër korsi nga Rahoveci deri në Xërxë. Për këtë projekt 3.4 milionë euro të hënën kanë

nënshkruar memorandum mirëkuptimi kryetari i Rahovecit, Smajl Latifi, dhe ministri i Infrastrukturs dhe Transportit, Pal Lekaj. Ky i fundit ka thënë se ministria që

drejton ka zotuar mjetet, ndërsa Komuna e Rahovecit është përgjegjëse për procedurat. "Presim implementim korrekt të projektit", ka thënë ministri Lekaj.

Samiti i Berlinit, më shumë simbolikë se substancë



Janusz BUGAJSKI

Samiti i Berlinit për Ballkanin Perëndimor pati më shumë simbolikë sesa substancë, megjithëse simbolizmi është i rëndësishëm në politikën ndërkombëtare.

Fakti që si kancelarja Angela Merkel, ashtu dhe presidenti Emmanuel Macron, u takuan me të gjithë liderët e Ballkanit Perëndimor, synonte të demonstronte angazhime të reja të BE-së në rajon. Por, mungesa e vendimeve konkrete ka gjasë të generojë cinizëm rreth rezultateve të këtij samiti, por edhe rreth takimeve të ardhshme. Tradicionalisht, samitet e mëdha ndërkombëtare mbahen kur është arritur një marrëveshje mes krerëve të shteteve dhe takimi thjesht mundëson ndjekjen e protokolleve të rëndësishme dhe nënshkrimin e dokumenteve. Në

rastin e samiteve të Ballkanit Perëndimor, një proces i nisur nga Berlino në vitin 2014 për ta rritur bashkëpunimin dhe sigurinë rajonale, shumë pak marrëveshje janë arritur në avancë. Si rezultat, rriten pritshmëritë se vetë samiti do të sjellë rezultate konkrete dhe kjo nga ana tjetër mund të krijojë zhgënjime.

Berlino mund të mburret me të paktën një arritje simbolike të Samitit: Prania e dy liderëve gjerman dhe francez nënvizoi faktin se Parisi tani është një aktor i rëndësishëm në procesin e Berlinit për Ballkanin Perëndimor. Ishte gjithashtu një takim i rëndësishëm për Macronin dhe Merkelin për të shfaqur një front të bashkuar pas tensioneve të fundit mes tyre mbi të ardhmen e BE-së dhe konturet e politikave ekonomike të Evropës.

Megjithatë, mangësitë e këtij samiti ishin më të dukshme. Edhe pse Serbia dhe Kosova ranë dakord që t'i rinisin bisedimet "konstruktive", ka pak optimizëm që këtë vit të ketë një normalizim të marrëdhënieve. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, me të drejtë theksoi se asnjë marrëveshje përfundimtare dypalëshe nuk

mund të arrihej pa praninë e Shteteve të Bashkuara, sepse BE-ja është shumë e dobët dhe e përçarë për t'i zgjidhur problemet ose të implementojë një zgjidhje në Ballkanin Perëndimor. Megjithëse, Gjermania dhe Franca do të vazhdojnë të nxisin Serbinë dhe Kosovën për dialog, takimi i ardhshëm i negociatorëve do të mbahet në Paris në fillim të korrikut.

Berlino gjithashtu nuk arriti ta zgjidhë mosmarrëveshjen e takës pas vendimit të Prishtinës nëntorin e shkuar për ta vendosur taksën 100 për qind ndaj mallrave serbe si shenjë hakmarrje ndaj Beogradit për lobimin kundër anëtarësimit të Kosovës në Interpol. Zyrtarët e Kosovës këmbëngulin që tarifa do të hiqet vetëm nëse Beogradi njeht pavarësinë e vendit.

Nga ana e tij, Berlino dërgoi një mesazh të fortë kundër çdo shkëmbimi territori mes dy protagonistëve. Kjo duket se bënë ndesh me disa sinjale që Uashingtoni ka dërguar gjatë muajve të fundit. Megjithëse vetëm mund të spekulohet për bisedat private, shumë shpejt u përhapën thashetheme se pas dyerve të mbyllura janë dhënë

mesazhe të forta, se nuk mund të ketë ndryshime të kufijve në rajon dhe se multietniciteti duhet të mbrohet në të gjithë Ballkanin Perëndimor.

Një tjetër dëshmitar i samitit: Aspiratat e Maqedonisë së Veriut për BE-në bënë shumë pak përparim pavarësisht se marrëveshja historike në mes të Shkupit dhe Athinës u vlerësua gjerësisht nga BE-ja.

Shkupi nuk mori një sinjal të qartë nga Franca, e cila mbetet skeptike rreth zgjerimit të BE-së në Ballkan, në lidhje me datën e hapjes së bisedimeve për pranimin në BE. Merkel u duk se bëri një përmbledhje të pritshmërive të pakta dhe rezultateve të dobëta simbolike kur tha se "samiti nuk ishte për marrjen e vendimeve, por për të pasur një bisedë të përbashkët dhe të sinqertë".

Për Shqipërinë, Samiti i Berlinit pati pak vlerë konkrete. Merkel dhe Macroni e bënë të qartë se ka pak mundësi për çdo aspirant të Ballkanit Perëndimor për t'iu bashkuar BE-së derisa të përfundojnë reforma të gjera, veçanërisht në lidhje me sundimin e ligjit. Paqëndrueshmëria e vazhdueshme politike e Shqipërisë dhe protestat publike sigurisht se

nuk e ndihmojnë vendin në aktivizimin e ofertës së anëtarësimit. Tirana nuk ka gjasë të marrë miratim për t'i filluar zyrtarisht bisedimet e pranimit këtë vit.

Një samit akoma më i gjerë, i gjashti i përvitshëm, do të mbahet në Poznan të Polonisë më 4-5 korrik. Takimi është planifikuar që të ndiqet nga kryeministrat, ministrat e jashtëm dhe ministrat e ekonomisë të gjashtë vendeve ballkanike, aspirante për BE, dy anëtare të BE-së (Kroacia dhe Sllovenia) dhe disa anëtare të tjera të BE-së si Austria, Franca, Gjermania dhe Italia ashtu si dhe përfaqësues nga institucione financiare ndërkombëtare.

Agjenda e Poznanit duket ambicioze dhe përfshin diskutime mbi investimet ekonomike, lidhjet ndërshtetërore, rinore dhe kulture, zhvillimin e shoqërisë civile dhe sigurinë rajonale. Por shpeshherë një agjendë e gjerë është thikë me dy presa, pasi çdo çështje trajtohet cekët. Mbi të gjitha, do të ketë shumë skepticizëm nëse në takimin e ardhshëm substanca do të prevalojë mbi simbolizmin.

(Marrë nga gazeta "Dita")

KLGI-ja mbështet procesin e formulës së financimit të qëndrueshëm të shërbimeve sociale në komuna

Prishtinë, 6 maj (ER) - Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGI), së bashku me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), organizuan punëtorinë me temën "Formula e Financimit dhe Kriteret për Grantin e Veçantë për Shërbimet Sociale". Në këtë punëtori u diskutua për format e financimit të shërbimeve sociale duke u bazuar në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal dhe Ligjin për Shërbimet Sociale dhe Familjare.

Pjesëmarrës në takim ishin anëtarët e Grupit Punues për përgatitjen e Formulës së Financimit dhe Kriteret për Shërbimet Sociale. "Megjithatë, buxhetet publike duhet të sigurojnë mbështetje të përshtatshme financiare për ofrimin e shërbimeve sociale, pasi kjo paraqet një investim efektiv dhe një element thelbësor të shoqërisë që në mungesë të kushteve kërkojnë mbështetje sociale. Në Ligjin e ri për shërbimet sociale Qendrat për Shërbime Sociale parashihen të kenë rol proaktiv e që kjo të parashihet edhe në formulën e financimit. Sa më shumë që është



e avancuar formula e financimit dhe ndarja buxhetore, aq më i madh do të jetë efikasiteti i funksionimit të qendrave për shërbimet sociale. Para së gjithash, nëse nuk ka menaxhim efektiv dhe ndarje të burimeve, ata që më së shumti kanë nevojë kanë gjasë ta gjejnë veten pa shërbime", është thënë në njoftimin e

Institutit Kosovar për Qeverisje Lokale.

Në këtë njoftim theksohet se në mungesë të burimeve të mjaftueshme publike për t'i plotësuar nevojat për mirëqenie është e rëndësishme përfshirja dhe roli i shoqërisë civile që janë aktive në këtë fushë për ta mbuluar zbrazëtirën dhe për t'i gjetur

një zgjidhje të qëndrueshme kësaj fushe. "Kërkesa për shërbime sociale po rritet për shkak të ndryshimeve demografike dhe shoqërore, migrimit të jashtëm dhe të brendshëm, papunësisë dhe faktorëve tjerë, që e bënë të domosdoshme përgatitjen e formulës së financimit për shërbimet sociale. Ofrimi i shër-

bimeve duhet t'i respektojë të drejtat e përdoruesve dhe të garantojë një nivel të lartë cilësie", është theksuar në këtë njoftim. Ky aktivitet u realizua në kuadër të projektit 'Mbështetje për Komuna më të Forta dhe më të Qëndrueshme (SSSM)' i financuar nga Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë në Kosovë.

E rrallë

Çifti kthen pyllin në 'jetë', mbjellin dy milionë pemë

Një çift ka kthyer në jetë një pyll të shkatërruar duke mbjellë më shumë se dy milionë pemë në 20 vjet. Fotografi Sebastiao Ribeiro Salgado u tmerrua kur zbuloi se një zonë pyjore që iu përkiste prindërve të tij ishte shpyllëzuar tërësisht. Kështu që ai dhe gruaja e tij, Leila, mbollën pemë



në parcelën prej 1 745 hektarësh përreth fermës së familjes së tij, duke përdorur vetëm farëra nga ai rajon.

FOTO E DITES



Shpërthim gjatë një sulmi ajror izraelit në qytetin e Gazës. /AFP/

E jashtëzakonshme

Lumi transformohet në 'ylber'

"Lumi i pesë ngjyrave" në Kolumbi ndodhet në parkun nacional Serrania de la Macarena në provincën Meta. Nga qershori deri në nëntor, muajt midis stinëve të lagështa dhe të thata, bimët e lumit krijojnë një shfaqje shumëngjyrëshe. Ngjyrat prodhohen gjatë procesit riprodhues të bimëve ujore të quajtura Macarenia clavigera. Gjatë sezonit të thatë lumi mbyllet për publikun për të lejuar që ekologjia e zonës të rigjenerohet nga ndikimi i vizitorëve.



BARSOLETA E DITËS



- Taksi**
- Sa euro më kushton transportimi deri në aeroport?
 - 25 euro.
 - Po nëse e marr edhe të dashurën me vete?
 - I njëjti çmim.
 - E sheh zemër se nuk vlen asnjë euro.




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"HOW TO TRAIN YOUR DRAGON; The Hidden World" 3D

I Animuar/Aksion Aventure; 1 ore 44 min

Rolet: Jay Baruchel, America Ferrera, Cate Blanchett, Kit Harrington, Craig Ferguson, F. Murray Abraham, etj.
Regjia: Dean DeBlois



Në ora 18:00 (gjate vikendit ne ora 14:00 dhe 18:00)

"THE KID WHO WOULD BE KING"

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 ore 50 min

Rolet: Louis Ashbourne Serkis, Dean Chaumoo, Tom Taylor, Rhianna Dorris, Angus Imrie, Rebecca Ferguson, Patrick Stewart, etj.

Regjia: Joe Cornish



Në ora 20:00

"CAPTAIN MARVEL" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 ore 08 min

Rolet: Brie Larson, Samuel L. Jackson, Ben Mendelsohn, Djimon Hounsou, Lee Pace, Gemma Chan, Annette Bening, Jude Law, etj.

Regjia: Anna Boden, Ryan Fleck




Në ora 22:00

"U S"

Horror/Triller; 1 ore 56 min

Rolet: Lupita Nyong'o, Winston Duke, Elisabeth Moss, Tim Heidecker, Yahya Abdul-Mateen II, Anna Diop, Evan Alex, Shahadi Wright Joseph, Madison Curry, Cali Sheldon, Noelle Sheldon

Regjia: Academy Award-winning visionary Jordan Peele



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

 <p>DASHI Në dashuri do t'ju hapen porta të reja që nuk i kishit imagjinuar. Një takim i rastësishëm do të jetë mjaft interesant.</p>	 <p>DEMI I gjithë fokusi juaj sot është përqendruar te financat dhe te karriera. Jeni në zhvillime shumë të rëndësishme për të ardhmen në këto fusha.</p>	 <p>BINJAKËT Një ditë e qetë dhe me të gjitha gjërat mirë të organizuara. Do të jeni mjaft të dashur me personat që keni afër vetes.</p>	 <p>GAFORRJA Po e nisni këtë ditë me këmbën e gabuar dhe kjo gjë do të reflektojë në çdo vendim tuajin në orët në vazhdim.</p>	 <p>LUANI Sot jeni shenja me më fat e horoskopit. Çdo gjë është siç dëshironi, madje disa situata do të dalin më mirë sesa që e prisnit.</p>	 <p>VIRGJËRSHA Jeni përqendruar në investime afatgjata, por dita e sotme do t'ju kushtëzojë të zgjidhni sa më shpejt disa probleme financash.</p>
 <p>PESHORJA Sot jeni ju protagonistët e ditës dhe kjo gjë do t'ju pëlqejë. Në çdo aspekt do të kërkonti më të mirën e gjërave.</p>	 <p>AKREPI Duhet të përshatani me ndryshimet sot. Do të ndodhin shumë shpejt dhe ju do të jeni të luhatur përgjatë gjithë ditës.</p>	 <p>SHIGJETARI Sot jeni përqendruar në objektivat që janë me të shpejta për t'i arritur. Persona afër jush duan të përfitojnë në atë që mund të arrini.</p>	 <p>BRICJAPI Sot nuk po organizoheni dot siç duhet. Fillimi i javës do t'ju gjejë kaotik dhe në rrëmujë e sipër.</p>	 <p>UJORI Do të jeni tip flirtues gjatë gjithë ditës. Keni mbi vete sharmin e personave që dinë çdo gjë dhe njohin këdo.</p>	 <p>PESHQIT Sot parashikohen debate me partnerin. Në shumë gjëra nuk do ta ndani të njëjtin mendim.</p>

Jennifer Lopezi e lë të fejuarin të presë gjysmë ore në restorant



Nëse je Jennifer Lopez ju mund të bëni që takimi të presë. Burime të "Page Six" kanë bërë me dije se Alex Rodriguez ishte në "Serafina" për një darkë me të


fejuarën e tij dhe ajo arriti një gjysmë ore me vonesë. Ish-bejsbollisti dukej i shqetësuar. "Ai dukej shumë i dashuruar. Jenniferi ishte shumë e bukur kur arriti", ka shkruar "Page Six".

Vjen në jetë djali i Princit Harry dhe dukeshës Meghan



Dukeshja Meghan ka sjellë në jetë djalin e parë me Princ Harryn. Ky i fundit ka dhënë njoftimin për lindjen e fëmijës së tyre. Meghan dhe Herry kanë falënderuar të gjithë ata që me urimet e tyre iu dhanë mbështetje. Princ Harry ka thënë se bashkëshortja e tij

dhe foshnja janë shumë mirë. "Jam shumë i emocionuar të lajmëroj se unë dhe Meghan jemi tashmë prindër të një djali, i cili është në një gjendje tepër të mirë shëndetësore. Jam tepër krenar për bashkëshorten time", ka thënë në deklaratën për media Princi Herry.



Blake Lively, shtatzënë për herë të tretë

Familja e Reynoldsve pritet të rritet. Blake Lively ka njoftuar se është shtatzënë dhe pret fëmijën e tretë kur është parë në qytetin e Nju

Jorkut në premierën e filmit "Pokemon: Detective Pikachu". Aktorja kishte veshur një fustan me ngjyrë të verdhë që nxirrte në pah barkun e saj të fryrë.

Miley Cyrus mban koncert në vendlindje pas një kohe të gjatë



Këngëtarja amerikane Miley Cyrus, pas një kohe të gjatë, është rikthyer për të performuar në vendlindjen e saj, Tennessee. Cyrus ka performuar

para një publiku të madh në kuadër të Festivalit "Beale Street Music". Ajo ka thënë se është ndjenjë e mirë të performosh përsëri në vendlindje.

(Trajtesë)

SHËN GJERGJI, FESTË PAGANE

Prof. dr. Vebi BEXHETI
Universiteti i Evropës
Juglindore
Tetovë

Ndër shumë festa të motmotit që deri vonë festoheshin e që në mënyrë më të zbehur festohen edhe sot, festa e Shën Gjergjit ishte festa më e dashur për shqiptarët në tërë shtrirjen gjeografike të kombit tonë. Ashtu si çdo festë tjetër pagane, që me vështirësi i përballuan ndikimet e ndryshme fetare, edhe kjo festë arriti deri në ditët e sotme, për të dëshmuar një civilizim të hershëm të historisë sonë. Ritet e kësaj feste me histori parakrishtere që kishin të bëjnë me ringjalljen e natyrës, me botën bimore e shtazore, origjinën e kishin nga hyjnitë vendëse të lashtësisë.

Këto rite pagane e kanë kryer me sukses misionin e vet, duke qenë gjithmonë në shërbim të njeriut dhe dëshirës së tij për mirëqenie e jetë të lumtur, rite këto që kishin të bëjë edhe me kultin e zjarrit, që sipas mitologjisë së hershme i jepte forcë diellit. Edhe më vonë, me paraqitjen e krishterimit, këto vazhduan ta bëjnë jetën e vet, pa iu nënshtruar presioneve fetare, që këtë festë pagane ta shndërrojnë në festë fetare.

Jeta e vështirë dhe jo e sigurt e shqiptarit ndër shekuj, e detyruan atë t'i ruajë deri vonë disa besime që bazoheshin në mite dhe rite magjike. Albanologu gjerman, Hahni, me kohë e kishte konstatuar se klerikët e krishterë i kishin luftuar me forcë këto rite pagane, si pjesë e festës së Shën Gjergjit. Se kjo festë ka të bëjë me kultin e pjellorisë e të bujqësisë, e dëshmon edhe vet emri Gjergj, që rrjedh nga greqishtja e vjetër e që do të

thotë bujk. Si nga origjina, ashtu edhe nga mënyra e manifestimit, shihet qartë se Shën Gjergji nuk ka karakter fetar, edhe pse më vonë emri Gjergj, ndër popuj të ndryshëm të mitologjisë krishtere, shfaqet si simbol shenjt. Tendenca që kjo festë të llogaritet si e krishterë nuk mban edhe nga fakti se vet ritet e kësaj feste kanë të bëjë me blegtoriale, bimësinë dhe mirëqenien e njeriut që vjen nga to.

Festa e Shën Gjergjit festohet në të gjitha vendet dhe krahinat shqiptare, nga Shqipëria veriore, e mesme, ajo jugore e Çamëria, Arbëreshët e Italisë, Kosova, Ulqini, Presheva e Maqedonia. Vet historiku i kësaj feste, karakteri pagan i saj, shtrirja gjeografike dhe mbi të gjitha mënyra e festimit nga shqiptarët e cilës do anë qofshin ata, sot nuk i jep të drejtë askujt ta nënçmojë këtë festë, ta konsiderojë si të huajë, madje edhe si kundër islame. Ka pasur raste kur kjo festë është festuar në të njëjtën ditë me atë të Bajramit dhe, jo që e kanë dëmtuar njëra tjetrën, por përkundrazi, solemniteti, gëzimi e hareja në ato raste e arrinin kulmin. Dita e Luleve dhe ajo e Shën Gjergjit ndonjëherë festoheshin edhe në Muajin e Ramazanit dhe besimtarëve myslimanë as që u pengonte ta festojnë këtë festë pagane me rrënjë të thella edhe për qytetërimin shqiptar. Nëse disa kombe, këtë festë e shohin nëpërmjet prizmit fetar të krishterë, gjë që dëshmohet edhe me përdorimin e kryqit që i zëvendësoi elementet pagane, apo si festë që sjell verën, që i jep fund acarit dhe vuajtjes së anëtarëve të familjes gjatë kohës së dimrit, për shqiptarët me më shumë besime fetare, e ruajti karakterin pagan duke gjetur edhe shtrirje të tjera me vlera të

mëdha etnokulturore, për të treguar kështu lashtësinë e vet në këto troje dhe ruajtjen e vlerave shpirtërore e materiale, si pjesë e rëndësishme e etnokulturës shqiptare.

Kjo festë aq e dashur për shqiptarët dhe me rrënjë në lashtësinë e vet kombit, tanimë është e pranishme në këngën popullore, në mitologjinë tonë dhe në kujtesën e më të vjetërve për kohën e rinisë së tyre, sepse Shën Gjergji tek shqiptarët, përveç karakterit ritual, përtëritjes së natyrës, atij praktik të prodhimtarisë dhe atij kalendarik, fitoi edhe karakterin e festës së të rinjve, u bë pjesë e jetës së tyre. Dita e Luleve që bie një ditë para Shën Gjergjit, më 5 Maj, me kohë, tek shqiptarët e shumë regjioneve, ishte shndërruar në ditë gëzimi e hareje të natyrës, aty ku lindte dhe shijohet dashuria. Vargjet e këngës popullore, të cilat konsiderohen si regjistruesi më besnik i këtyre vlerave, që nuk e patën lehtë të mbijetojnë, janë dëshmitari më objektiv, që tregojnë karakterin jofetar të këtyre festave, përfshirë edhe këtë të Shën Gjergjit dhe sidomos Ditës së Luleve, që i paraprinë atij. Këngët popullore, të shënuara në fshatin Veshallë, në mënyrë të mrekullueshme e përshkruajnë karakterin e zhveshur të kësaj feste nga cila do qoftë fe. Vargjet lirike të këtyre këngëve, temë kryesore e kanë dashurinë dhe momentet e ndjeshme që vajzës së fejuar ia përkujtojnë kohën kur ajo nuk do ketë mundësi të jetë në mesin e shoqeve, gjatë këtyre dy ditëve të kësaj feste. Brenda këtyre këngëve do hasim edhe një sërë ritesh që kanë të bëjë me jetën, dashurinë, ditët e vajzërisë me veshjet e saj, që një ditë do zëvendësohen me ato të nuses dhe lamtumirën e jetës

beqare. Çelja e gjetit, si paralajmërues se ka ardhur pranvera, që Ditën e Luleve e zbukuron më tepër, për poetin popullor lidhet edhe me dashurinë mes djalit dhe vajzës, që në këtë rast na vjen me emrin e thëllëzës (O lum e lum, na ka çel xhethi, / do dahet i majri e i keçi / i keçi le shkoje te nona, / i majri le shkoje te folloza).

Meqë Dita e Luleve ishte vetëm për vajzat beqare e jo edhe për gratë e martuara, kjo ditë për to ishte shumë e rëndësishme, sepse me këtë festë që vinte një herë në vit, ato matnin edhe vitet e beqarisë, që shkonin shumë shpejt dhe kështu vit për vit zvogëlohej numri i shoqeve që së bashku duhej ta pritnin këtë ditë të bekuar edhe nga zoti: (O lumët ne për të lumin Zot, / do shkojna për lule ene mot, / o ene mot ene qetër mot, / o hala imi shoqë plot, / do na vaje motja o sikur sot). Se sa ishte e lidhur emocionalisht kjo ditë me të dashurin e vajzës, tregojnë edhe vargjet: (Ditën e Shënxhexhit, / gjith ditën kom ka, / kmejsa e dilberit, / më ka metë pa la). Veshja popullore e vajzave zuri vend edhe në këto vargje, sepse ajo ishte e lidhur me statusin martesor të tyre: (O çelni molla e çelni dardha, / se jon vesh caucat me skutaçe t'bardha, / molla e dardha le t'çelin, / shiqir xhi e prej tëm Shënxhexhin, / Kaj moj motër, njen sa t'çeje xhethi, / ilvida te ne nat Shënxhexhi. / Oj Alije honom kuj d'ja loxh xhaketin, / d'ja lo shoçes teme, / ta boje Shënxhexhin, / xhi punon Lulije honom hije napër hije, / Shënxhexhin qetër me sontije, / xhi punon Alije honom ferra napër ferra, / për Shënxhexhin qetër me tela).

Ndarjen e një shoqeje nga grupi i vajzave që bëhen gati për këtë festë, meqë ajo ishte martuar, e përjetuan shumë keq shoqet e saj, kjo ditë për to nuk e kishte bukurinë e viteve të kaluara: (O ki Sënxhexhi i siveçëm, / pa shoçen teme shaum i beçëm, / për shoçen teme mi vajn shaum keç, / se nouk e mrrejni kët Shënxhexh). Vargjet e këtyre këngëve bëjnë fjalë edhe për fejesën e vajzave, status ky që ndoshta në raste më të rralla mund ta kufizojë lirinë, e në këtë kontekst, edhe të drejtën e shkuarjes për lule: (Oj Florije honom, oj fodulle, / pajtën Agim aga, a do vajsh për lule, / une do vej me kit shoçet, / se mas ni jave do m'vajn bofçet. / Ka çel xhethi i Vardishës, / ne do shkojm për lule, / a do vejsh ene tej, Florije fodulle, / un do vej ta shoh Agim agën, / m'prejtni ta pajtoj une babën, / mos e pajt as



nonën as babën, / di javë mas Shënxhexhi do t'apën).

Kurbeti, bagëtia dhe ringjallja e botës bimore, në këto shpërthime lirike, ku gjithmonë është e pranishme edhe dashuria, janë temat e vazhdueshme përmes të cilave, këngëtari anonim popullor, e paraqet të vërtetën e madhe se kjo festë nuk ka të bëjë me çështje religjioze. Toponimet e ndryshme të hapësirës ku krijohen këto vargje, janë edhe një dëshmi se kjo festë me rrënjë në lashtësi, me kohë ka fituar edhe tipare autoktone të rajoneve ku jetojnë shqiptarët: (Do shkojna për lule ka Vardisha, / di mushim udhët ka kisha, / do shkojna për lule napër ara, / kit gjemt e ri, do hecin përpara. Do shkojm për lule, se na ka dal vera, / do vajn dhent ka kulla me shqerra. Do shkojm për lule, / se na ka çel xhethi, / do vejn gjemt e ri pi kurbeti). Edhe poeti ynë i madh, Lasgush Poradëci këtë ditë festive me karakter gëzimi, dashurie e hareje e futi në vargjet poetike të një poezie. Personazhja e poezisë të tij, kushtuar Ditës së Luleve, kur takohet diku në mal me dashnorin, vendos të mos kthehet më me shoqet, prandaj edhe i porositi ato që t'u tregojnë prindërve se atë, në një përrua e "zuri gjarpushja". Kjo ditë që i paraprin Shën Gjergjit, këtë festë e pasuron me elemente të reja që u bënë tradicionale në botën shqiptare. Për këtë pjesë të festës së Shën Gjergjit, Ditën e luleve, tregojnë pleqtë dhe



E QYTETËRIMIT TË LASHTË



plakat, se të rinjtë që ndodheshin në kurbet edhe në vende më të largëta, vinin për pak kohë që të jenë pjesë e manifestimit me këtë rast, për ta shijuar këtë festë të bukur, që për shqiptarët mbeti krejtësisht e zhveshur nga elementi fetar.

Ashtu si në shumë vendbanime të tjera shqiptare, edhe në ato të Malësisë së Tetovës, të rinjtë, me kohë e kishin marrë hisen e vet nga kjo festë e natyrës. Në fshatin Veshallë dhe Bozovcë të Malësisë së Sharrit, vajzat bashkë me djemtë dalin në natyrë të mbledhin lule. Karakteristikë e këtij manifestimi, që si duket është edhe unikat, në tërë botën shqiptare, është se në këtë takim pas një udhëtimit të gjatë nga fshati, përveç djemve të rinj e burrave, marrin pjesë vetëm vajzat, e assesi gratë e martuara. Është me rëndësi për këtë rast të përmendet se ky takim bëhej vetëm në një vend të caktuar, që me kohë e kishte fituar toponimin "Guri i cucave" (Gjuri caucave), i cili gjendet në kufirin që e ndan rajonin e këtyre fshatrave. Ky vend, me shekuj i pret të rinjtë, të cilët që nga mëngjesi deri vonë pas dite, e kalojnë kohën duke mbledhë lule, duke kënduar e duke hedhur valle. Një karakteristikë tjetër për këtë moment është edhe radhitja e luleve në ndonjë lëndë, degë apo bime, që në formë kurore, bashkë me lulet e radhitura, vajzat i venin në kokë dhe i mbanin ashtu deri në shtëpi. Kjo kurorë është vet elementi i

lashtë i qytetërimit të hershëm, nga koha ilire që karakterizohet me mbretërinë dhe me mbretëreshën Teutë.

Festimi i Ditës së Luleve vazhdon me natën e Shën Gjergjit, me ceremoni të shumta. Nga mëngjesi i ditës së Shën Gjergjit të rinjtë vazhdojnë me valle, këngë e luhatje në tërkuzë të varur në ndonjë pemë. Përveç elementit festiv dhe ceremonial, ku bartës ishin të rinjtë dhe të rejat, kulti i bimësisë për pjellori e mbarësi, zë vend shumë të rëndësishëm. Me këtë rast barinjët i kripnin bagëtitë me kripën e përzierë me bimë të ndryshme e veçmas me një bimë që quhej "Qepë arushe" (bimë gjthëgjërë me aromë qepe e hudhre).

Një shtrirje shumë e gjerë në hapësirat shqiptare për këtë festë, karakteristike është edhe Krandja e Shën Gjergjit (kësaj dege me gjethe i thonë kështu në Lumë dhe në disa vende të tjera të Kosovës), ose Potkat, siç quhet ndryshe kjo degë, që nuk është më e shkurtër se një metër. Është traditë që herët në mëngjes, ende pa zbardhur mirë, burrat e shtëpisë të dalin nëpër ara e livadhe, t'i ngulin këto degë për të lajmëruar se ato vende shpallen zona të ndaluara për kullotje. Arat që nuk e kishin këtë simbol, llogariteshin si të pa zot. Nga ky qëllim i vënies së Potkave, ky rit mori edhe kuptime të tjera, duke u shtrirë në vende dhe objekte të ndryshme. Degë të ndryshme por edhe lule gjendeshin kudo: në oborr,

nëpër enë shtëpiake, dyer, dritare, që kishin kuptimin e shëndetit, mirësisë, dhe ringjalljes. Riti i zjarrit që është i pranishëm në shumë rajone ku festohet Shën Gjergji, është gjithashtu i lashtë. Edhe sot në rajonin e fshatit Reçan të Gostivarit, dhe në shumë hapësira të tjera shqiptare, gjatë tërë natës së Shën Gjergjit, ndizen zjarre të mëdha ku bëhen edhe ceremoni të tjera që zgjasin deri në mëngjes. Këto zjarre kanë të bëjë me kultin e diellit dhe me forcën e tij që jep jetë e fuqi.

Përveç këtyre vlerave etnokulturore dhe etnologjike në përgjithësi, që ishin pjesë e riteve të shumta të festës së

Shën Gjergjit, kjo festë luajti edhe rolin praktik të matjes kalendarike të kohës, për të planifikuar një sërë aktivitete që lidhen me kohë të caktuara. Dita e Shën Gjergjit që gjithmonë sipas kalendarit të sotëm bie më 6 maj, konsiderohet edhe si kryemotmot, prandaj edhe numërimet e ditëve, para ose pas kësaj feste, e kanë për bazë pikërisht atë. Periudha kohore Shën Mitër (shmitër, shmejtër) e Shën Gjergj (Shën xhexh) ishte koha sa mund të zgjaste kontrata e kurbetit për "hizmeqarin", që do të shërbente në familjet më të pasura, i cili zakonisht kujdesej për bagëtinë. Shën Gjergji ishte koha e caktuar, deri kur mund të paguhej një borxh, nëse është blerë bagëti ose ndonjë pronë e patundshme. Në këtë kohë ndalohet kullotja e bagëtisë nëpër zonat që nuk planifikohen për kullotje. Shumë pak, pas Shën Gjergjit vijnë barinjët me bagëtitë e tyre nga vendet ku kishin qëndruar gjatë dimrit, në Shën Gjergj ndahen qengjat nga delet, e pak më vonë dilet edhe në stan. Shën Gjergji është koha e tubimeve të ndryshme të fshatarëve për të zgjedhur njerëz përgjegjës për punët me interes më të gjerë: zgjidhet rojtari i arave, ai që do t'i ruajë lopët e fshatit dhe bagëtitë e tjera dhe bëhen një sërë aktivitete me interes për banorët e këtyre rajoneve rurale. Aspekti pagan, si element me rëndësi për autoktoninë dhe lashtësinë e kombit tonë, ai mitologjik si vlerë shpirtërore që na radhit mes kombeve me qytetërim shumë të hershëm dhe shumë elemente më të reja, që u bënë pjesë e kësaj feste, mbeten vlera universale të paluhatshme që gjatë historisë përveç rolit të përbashkët me

popuj të tjerë të vjetër dhe qytetërimet e tyre të bazuara në besime e shumë qenie mitike, luajtën rol të rëndësishëm edhe në afirmimin e veçorive dalluese të shqiptarëve. Këtë festë aq të rëndësishme dhe me vlera të pakrahasueshme duhet ta respektojmë, ta kultivojmë, ta ruajmë edhe në të ardhmen, ashtu siç reflektoi ajo me kontributin historik për t'i ruajtur vlerat shpirtërore të bazuara në mitologjinë popullore shqiptare, të rëndësishme për etnokulturën e kombit tonë. Me këtë rast vetëm sa i përmendëm disa nga shumë vlera të tërësisë së kësaj pasurie kulturore të shqiptarëve. Kjo festë që i përballoi sfidat e kohës dhe arriti deri në ditët e sotme, pa u bërë pjesë e interesit të krishterë, do t'i përballojë edhe këto që kohët e fundit vijnë nga individë dhe teologë të pandërgjegjshëm të disa qarqeve ekstreme islame, që fenë e keqpërdorin edhe për këso qëllimesh. Kjo festë, që me gjithë vështirësitë e përballoi historinë, herë-herë të ashpër kundër qytetërimeve pagane, si duket, tani e ka më vështirë të mbijetojë. Globalizimi, integrimi dhe modernizimi i jetës së njeriut, e në këtë rast edhe i shqiptarëve, sidomos migrimi i popullatës sonë, tanimë janë armiku më i madh i këtyre vlerave tradicionale dhe kulturore. Këto vlera etnologjike që po zbehen dita-ditës dhe po mbeten vetëm në kujtesën e gjeneratave, duhet të jenë brengosje serioze e të gjithë atyre që me punë e dije, këto festa të motmotit dhe vlera të tjera, t'i studiojnë dhe t'i bëjnë pjesë të shkencës sonë, që për gjeneratat e ardhshme të njihen së paku si trashëgimi etnologjike e kulturore të vërtetë uara edhe shkencërisht.



EUROGLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"

TEL: 045 82 82 82

Livoreka: Drita do të angazhohet maksimalisht edhe ndaj Feronikelit

Përparim Livoreka ka thënë për "Epokën e re" se Drita është e gatshme ta ndalë Feronikelin ashtu siç bëri ditë më parë me Prishtinën. "Do të jetë një ndeshje shumë interesante dhe e fortë, pasi dihet se Feronikeli ka një skuadër cilësore dhe në këtë ndeshje është vendës. Ne do të përgatitemi në maksimum. Synim e kemi të marrim rezultat pozitiv edhe në këtë ndeshje", ka thënë Livoreka



ku vlen të ceket se në ndeshjen e fundjavës Drita e ndali në barazim Prishtinën (1-1), duke e lënë një hap pas në garën për titull. Sulmuesi Përparim Livoreka ka thënë të hënën për "Epokën e re" se skuadra e Dritës është duke e respektuar në maksimum kampionatin dhe në secilën ndeshje hyn për rezultat pozitiv. "Ne po përgatitemi për secilën ndeshje dhe cilin kundërshtar. Lirisht mund të them se Drita po luan

futbollin më të mirë, edhe pse nuk ka ambicie në këtë sezon, pra është jashtë objektivave në kampionat dhe Kupës. Megjithatë, jemi duke u mundur ta respektojmë në maksimum kampionatin dhe deri në ndeshjen e fundit do

dhe e fortë, pasi dihet se Feronikeli ka skuadër cilësore dhe në këtë ndeshje është vendës. Ne do të përgatitemi në maksimum dhe synim e kemi të marrim rezultat pozitiv edhe në këtë ndeshje", ka thënë Livoreka, duke shtuar: "Ende nuk e dimë për mungesa por, pavarësisht se kush luan, që të gjithë do ta japim maksimumin për hir të kampionatit". Skuadra e Dritës, e cila në edicionin e kaluar u shpall kampione e Kosovës, kurse më pas u paraqit në garat paraeliminatore të Ligës së Kampionëve, e prezantoi Kosovën në mënyrë dinjitoze. Aktualisht ky klub renditet në pozitën e katërt me 48 pikë, duke mos qenë i përfshirë në luftën për titull e as në luftën për mbijetesë në Superligë.

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 6 MAJ - Kampionia në fuqi e IPKO Superligës së Kosovës në futboll, Drita nga Gjilani, e ka humbur hapin për titull dhe është eliminuar nga gara e Kupës. Mirëpo kjo nuk po e pengon këtë skuadër të zhvillojë lojërë të mira dhe të marrë rezultate pozitive, duke e bërë kampionatin edhe më interesant në xhirot e fundit,

Finalja, mision 'i pamundur' për Liverpoolin

LIVERPOOL, 6 MAJ (ER) - Kualifikimi në finale duket mision 'i pamundur' për skuadrën e Liverpoolit, e cila pësoi humbje në ndeshjen e parë gjysmëfinale nga Barcelona (3-0). Përveç diferencës së madhe të golave, skuadra e Liverpoolit për ndeshjen kthyesë ka probleme të mëdha edhe me lëndime pasi Naby Keita, Roberto Firmino dhe Mohamed Salah janë të lënduar. Ndërsa edhe Adam Lallana nuk ka luajtur nga muaji mars me arsye ende të pazbuluara. "Ne do të provojmë ta fitojmë ndeshjen. Nëse në ndonjë moment specifik ata na japin mundësinë për të shkuar tutje në raundin tjetër ne do ta provojmë. Së bashku me tifozët tanë ka



qenë një edicion i gjatë. Ka pak shanse që të bëhet më i gjatë, por këto janë dy ndeshjet e fundit (duke

përfshirë edhe atë ndaj Wolverhamptonit në Premierligë) në shtëpi të një edicioni të jashtëza-

FORMACIONET E MUNDSHME

LIVERPOOL: ALISSON, ALEXANDER-ARNOLD, MATIP, VAN DIJK, ROBERTSON, FABINHO, HENDERSON, MILNER, WIJNALDUM, MANE, ORIGI.
BARCELONA: TER STEGEN; SEMEDO, PIQUE, LENGLET, ALBA; BUSQUETS, RAKITIQ, VIDAL; MESSI, SUAREZ, COUTINHO.

konshëm. Rezultati në Barcelonë nuk na ndihmoi shumë, të jem i sigurtë. Ne provuam shumë që të shënonim. Ne e kemi atë rezultat dhe duhet të pajtohemi me këtë. Le ta provojmë me gjithçka që kemi", ka deklaruar Jurgen Klopp. Mungesat e shumta në formacionin e trajnerit Jurgen Klop mund të jenë pozitive për shqiptarin Xherdan Shaqiri, i cili mund të ketë

rast të luajë në këtë ndeshje shumë të rëndësishme për klubin dhe një rast për të dëshmuar vetën para trajnerit Klopp. Në anën tjetër, Barcelonës do t'i rikthehen në formacionin bazë lojtarët kryesorë të cilët u pushuan në ndeshjen e fundjavës ndaj Celta Vigos, kurse Ousmane Dembele është lojtari i vetëm që është në dyshim për këtë ndeshje.

KB Rahoveci tërhiqet nga organizimi i ndeshjeve për Kosovën

RAHOVEC, 6 MAJ - KB Rahoveci nëpërmjet një njoftimi për medie ka bërë me dije se është tërhequr nga organizimi i ndeshjeve të Përfaqësues së Kosovës në basketboll. Ky vendim ka ardhur pasi në Kuvendin Komunal është votuar rregullorja për mirëmbajtjen e palestrës sportive

"Mizahir Isma". "Palestra duhet të ketë zot shtëpie dhe për këtë bordi i KB Rahovecit ka dhënë propozime se si duhet të gjendet zgjidhja, që palestra të menaxhohet në mënyrë të përbashkët nga klubi dhe komuna. Ne u jemi falënderues autoriteteve të komunës të cilët e kanë ndih-

muar klubin në secilën formë, por konsiderojmë se ndihma dhe një veprim i tillë me rregulloren nuk i përkasin një bashkëpunimi të sigurtë, pasi nuk ka qëllim zhvillimin e klubit dhe sportit në përgjithësi në komunën tonë. Për këto arsye bordi i KB Rahovecit, në shenjë

mospajtimi me këtë vendim të Kuvendit Komunal, është tërhequr nga organizimi i dy ndeshjeve ndërkombëtare të Kosovës ndaj Britanisë së Madhe dhe Luksemburgut. Për këtë vendim janë të njoftuar edhe autoritetet e FBK-së", thuhet në njoftimin e KB Rahoveci.



Dënohen Mullaomeroviqi, Berisha, Minnisi dhe KB Rahoveci

PRISHTINË, 6 MAJ - Trajneri Damir Mullaomeroviqi nuk do të mund ta udhëheqë Z Mobile Prishtinën në ndeshjen e tretë të serisë finale kundër Rahovecit që luhet

të martën (20:30). Mullaomeroviqi të hënën është gjobitur dhe suspenduar nga Komisari i Garave të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK). Ai

ka marrë një gjobë prej 300 eurosh dhe është suspenduar për një ndeshje, të tretën për shkak të sjelljeve ndaj personave zyrtarë në duelin e fundit, të cilin

Prishtina e humbi në Rahovec. Për këtë ndeshje është gjobitur edhe Dardan Berisha, por me 100 euro për shkak të gabimit teknik. Pa gjobë nuk ka shpëtuar as

Rahoveci. Rahovecit i është shqiptuar një gjobë prej 300 eurosh derisa lojtari Deshon Minnisi është gjobitur me 100 euro.

Casillasi del nga spitali: Faleminderit të gjithëve!

PORTO, 6 MAJ - Iker Casillasi ka dalë të hënën nga spitali, pas sulmit që pësoi në zemër të mërkurën e kaluar. Portieri spanjoll falënderoi mjekët dhe mijëra njerëz që i kanë qen-

druar në krahë në këto çaste të vështira. "Duhet të jem mirënjohës, sepse kam qenë shumë me fat. Dua të falënderoj shumë njerëz. Ata më kanë bërë të ndihem i vlerë-

suar në një çast të vështirë. Dua ta falënderoj spitalin dhe mjekët të cilët bënë ndërhyrjen. Jam i befaspur nga dashuria dhe mbështetja që provova këto ditë nëpërmjet

rrjeteve sociale. Nuk e di se cila do të jetë e ardhmja, por më e rëndësishme është të jem këtu. Ju falënderoj të gjithëve! Shihemi së shpejti!", ka thënë Casillasi.



Ekipi i xhudos, i gatshëm për lojërat evropiane 'Minsk 2019'

PRISHTINË, 6 MAJ - Ka shkuar në tetë numri i sportistëve që do ta përfaqësojnë Kosovën në lojërat e dyta evropiane 'Minsk 2019' që mbahen prej 21 deri më 30 qershor në kryeqytetin e Bjellorusisë. Organizatori i LE 'Minsk 2019' i ka konfirmuar Komitetit Olimpik të Kosovës pjesëmarrjen e pesë xhudistëve tanë, Majlinda Kelmendi, Nora Gjakova, Distria Krasniqi, Akil Gjakova dhe Loriana Kuka, të cilët janë kualifikuar me normë. Distria është bartësja e dytë në kategorinë deri 48 kilogramë, Majlinda është e katërta (-52 kg), Nora e para (-57 kg), Akili i katërti (-73 kg), ndërsa Loriana e teta (-78 kg). Distria Krasniqi u shpreh se ata janë vazhdimisht duke ushtruar dhe duke u përgatitur për këto lojëra, ku do të synojnë të kthehen me medalje, raporton "KosovaPress". "Ne si ekip jemi duke u përgatitur shumë për këto lojëra evropiane, që ta përfaqësojmë Kosovën sa më mirë dhe të kthehemi me sa më shumë medalje. Në këtë garë synimi im është që të kthehemi me medalje, por synimi kryesor të kthehem me medaljen e artë. Normalisht, çelësi i kësaj suksesi është puna të cilën ne e bëjmë si ekip, por edhe puna e trajnerit tonë. Së fundi kam pasur shumë suksese pasi që e kam ndërruar kategorinë dhe jam numër 1 në ranglistën olimpikë për të shkuar në Tokyo, në Lojërat Olimpikë. Pra, gjithçka është duke shkuar mirë. Shpresoj vetëm të mos kem lëndime", u shpreh Krasniqi.



Kjo do të jetë hera e parë për xhudisten Loriana Kuka që do të marrë pjesë në lojërat evropiane. Ajo shpreson që nga kjo garë të rikthehet me medalje. "Përgatitjet po shkojnë mirë. Është hera e parë që do të marr pjesë në lojëra evropiane. Shpresoj t'i tregoj aftësitë e mia. Për secilin prej neve që do të marrë pjesë, synimi është të marrë një medalje, e arta normalisht se është më e mira, por për secilin nuk ka lidhje se çfarë. Në çdo pjesëmarrje, në çdo garë është njëjtë për mua, a është këtu në Kosovë apo jashtë Kosovës, kështu që nuk besoj që do të ketë problem me lëndime", ka deklaruar Driton Kuka. Ndërsa xhudistja tjetër, Nora Gjakova, shprehet tejet e kënaqur me ecurinë e përgatitjeve që janë duke i bërë, duke theksuar se Driton Kuka është personi që është duke e kryer punën më të madhe. "Përgatitjet po shkojnë shumë mirë. Jemi kthyer javën e

kaluar prej përgatitjeve në Romë dhe kur jemi kthyer këtu, kemi pasur mysafirë nga Turqia, Mali i zi, Bosnja. Kur po kemi kështu mysafirë prej shteteve të tjera, po na ndihmojnë shumë, sidomos për sparing, që është i domosdoshëm në këtë fazë që jemi tani para lojërave evropiane. Unë para katër vjetëve kam qenë medalistja e vetme në Lojëra Evropiane, e kam fituar medaljen e bronzit. Shpresoj që këtë vit të jem pjesë e podiumit. Normalisht qëllimi im kryesor do të jetë medalja e artë, por nëpër gara të tilla çdo medalje e ka vlerën e madhe", ka thënë Gjakova. Momentalisht ekipi i xhudos i udhëhequr nga Driton Kuka gjendet në Paris, ku ka vazhduar fazën tjetër përgatitore për këto lojëra evropiane. Kujtojmë se pikërisht në xhudo Kosova numëron një medalje të bronzit të fituar nga xhudistja Nora Gjakova, në debutimin e ekipit tonë në Baku 2015.

Leonard nderon raptorsat, Nuggetsit rikthen baraspeshën

PORTLAND, 6 MAJ - Toronto Raptors dhe Denver Nuggets kanë triumfuar në ndeshjet e katërta dhe kanë vendosur balancën. Kanadezët ia dolën ta mposhtnin Philadelphia 76ers me rezultatin 96-101, kurse Nuggetsit theu Portland Trail Blazersin 112-116. Kështu do të ketë minimalisht edhe nga dy përballje mes këtyre ekipeve për ta siguruar kalimin në finalen e konferencave. Kawhi Leonard mori situatën në dorë për Raptorsin, duke ia dalë të shënojë 39 pikë. Ai gjithashtu asistoi pesë herë, si dhe rikuperoi 15 topa në tabelë. Leonardo pati edhe mbështetjen e shokëve,



GJYSMËFINALET E KONFERENCAVE

Philadelphia 76ers - Toronto Raptors	96-101 (2-2)
Portland Trail Blazers - Denver Nuggets	112-116 (2-2)

pasi katër prej basketbollistëve të Raptorsit realizuan mbi 10 pikë. Jimmy Butler (29 pikë, 4 asistime, 11 rebound) ishte ai që spikati për 76ers. CJ McCollum (29 pikë)

dhe Damian Lillard (28 pikë) nuk i mjaftuan Portland Trail Blazersit që arriti të kishte një epërsi të lehtë në tri perioda. Nuggetsit e bënë diferencën në periodën e tretë, kur shënoi 13 pikë më shumë dhe mori epërsinë. Periodën e fundit Blazers nuk ia doli ta përmbyste rezultatin. Nikola Jokic (21 pikë, 11 asistime, 12 rebound) vijon të regjistrojë "triple-double", i katërti në fazën "play-off". Shënuesi më i mirë ishte Jamal Murray, me 34 pikë të realizuara. Ndeshje të mirë bëri edhe Paul Millsap, autor i 21 pikëve dhe 10 topave të rikuperuar në tabelë.

SHKURT

Dortmundi, 35 milionë euro për Rashicën

Reprezentuesi i Kosovës në futboll, Milot Rashica, po shkëlqen te Werder Bremen në Gjermani dhe kjo ka bërë që shumë skuadra të shfaqin interesim për shërbimet e tij. Borussia Dortmundi është skuadra kryesore që pritet të bëjë një ofertë për Rashicën e cila është në vlerë prej 35 milionë eurosh. Në skuadrën e Dortmundit e shohin Rashicën si zëvendësues ideal për Sancho, i cili pritet të transferohet nga Real Madridi.

Jamesi, afër Napolit

Bayern Munchen vendosi përfundimisht të mos e blinte mesfushorin James Rodriguez. Tashmë 27-vjeçari do të kthehet në Madrid, ku e pret përsëri Real. Qëndrimi në Madrid duket i pamundur dhe mediet italiane raportojnë se interesim për mesfushorin kolumbian ka treguar Napoli. Raportet e mira që ka trajneri Carlo Ancelotti me James Rodriguezin mund të jenë vendimtare në transferimin e tij në Serinë A.

Ruizi, Joshuas: Jam gati, po vij për ty

Boksieri Andy Ruiz Jr ka folur përpara meçit të 1 qershorit kundër Anthony Joshuas. Boksieri amerikan ka thënë se muskujt e britanikut nuk e trembin aspak përpara duelit që zhvillohet në "Madison Square Garden" të Nju Jorkut. Ruiz në karrierën e tij ka 32 fitore dhe vetëm një humbje, por do të ndeshet për titujt kampionë bote në peshën e rëndë në kategoritë IBE, WBA dhe WBO që mbahen nga Joshua. "Duhet ta pranoj që ai është kampion bote, gjë për të cilën nuk ka asnjë diskutim. Por edhe unë tashmë jam një boksier i madh. Anthony, e pranova këtë sfidë për ty, për të të mposhtur dhe treguar vendin. Edhe unë jam i fuqishëm, një boksier ku kombinohet teknika dhe shpejtësia, që ishte edhe arsyeja kryesore pse e pranova sfidën. Shumica po më nënvlerësojnë, sidomos nga pamja ime", ka deklaruar Ruiz, duke shtuar se: "Gjithsesi, kur të shohin grushtet e mia, do ta kuptojnë forcën time".

Bayerni, 100 milionë për Sanen

Leroy Sane nuk është duke kaluar nëpër një moment të mirë te Manchester City. Ylli gjerman ka raporte të tensionuara me trajnerin e Cityt, Pep Guardiola. Ka qenë strategu spanjoll që i ka kumtuar lajmin klubit se nuk e dëshiron Sanen në skuadër për edicionin e ardhshëm. Në anën tjetër, Bayerni mbetet skuadra e interesuar për të nënshkruar me Sanen që shihet si zëvendësues për Franck Riberyn. Kampionët e Gjermanisë janë gati të shpenzojnë 100 milionë euro për rikthimin e Sanes në Bundesliga.

Michael Schumacher: Ëndrra ime mbetet t'i arrij sukseset e babait

Mick Schumacher po shkon hapave të babait të vet, legjendës së Formulës 1 Michael Schumacher. Ai ka deklaruar se garimi në Formula 1 është i pashmangshëm për të. "Momentalisht nuk mund ta krahasoj veten me asnjë pilot. Tani për tani krahasohem vetëm me vetveten. Ëndrra ime mbetet t'i arrij sukseset e babait. Garimi në Formula 1 është pjesë e fatit tim, është shkruar që më parë", ka deklaruar 19-vjeçari. Mick në këtë edicion do të garojë në Formula 2 me makinën Prema. "Për mua është e rëndësishme që t'i bëj hapat një e nga një, ndaj garimi në Formula 2 ishte i rëndësishëm para se të debutoj në Formula 1. Nuk e di se kur do të garoj në kampionatin më të bukur, por di që një ditë kjo gjë ka për të ndodhur", përfundoi talenti i akademisë së Ferrarit.

Pjaniqi 'tremb' Juven: PSG-ja është klub i madh

Miralem Pjaniqi "tremb" tifozët e Juventusit me deklaratën e tij për "Canal+" të Francës. Mesfushori boshnjak nuk e përjashtoi mundësinë e largimit nga bardhezinjtë, për t'iu bashkuar PSG-së, që e konsideroi një klub të madh në Evropë. "Jam prej tetë vjetësh pjesë e Serisë A, luaj në një klub të madh dhe të gjithë duhet të jenë dakord për këtë. Për momentin nuk po mendoj për këtë, por për ta mbyllur sa më mirë sezonin tim. Të shohim se çfarë do të ndodhë gjatë pushimeve. E respektoj shumë këtë klub ku luaj në lojtarë shumë të mirë", ka thënë Pjaniqi. "Objektivi im kryesor është ta fitoj Ligën e Kampionëve", ka shtuar ai.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerziteteske Bolničke i Kliniçke Sluzbe Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Klinike Universitare e Kosovës – Universitetski Kliniçki Centar Kosova – University Clinical Center of Kosovo
Sektori i Personelit



Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit të 4 Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik; Nenit 6 pika 1.1 dhe nenit 13 pika 1 dhe 3 e Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinikë Universitar të Kosovës, (SHSKUK), nenit 12, nenit 13 pika 1 dhe nenit 15 të Statutit të Qendrës Klinikë Universitare të Kosovës; Nenit 62 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 04/L-125, për Shëndetësi; Nenit 5 të Rregullores mbi Marrëdhënien e Punës nr. 1003 datë 21.07.2016 dhe Kërkesa nr. 118, të datës 25.04.2019, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së shpallë:

KONKURS

Institucioni: Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Qendra Klinikë Universitare e Kosovës (QKUK)

- Mjekë Specialistë të Pulmologjisë në Klinikën e Pulmologjisë (3 pozita)

I. Koeficienti i pagës: (8.4) Për Mjekë Specialistë
Norma e punës: Orar i plotë (40 orë në javë)
Kontrata: Sipas legjisllacionit në fuqi
Raporton: Shefit të Repartit të Klinikës në QKUK
Nr. i Referencës: QKUK – 16/2019-05/3

Qëllimi kryesor i vendit të punës për Specialistë:

Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në kuptimin cilësor e sasior bazuar në nivelin profesional që ka.

Përgjegjësit kryesorë të mjekut specialist:

- Bashkë me Shefin e repartit dhe stafin tjetër drejtues menaxhon me resurset humane, pajisjet, objektet e inventarin për nivelin të cilit i takon.
- Siguron standarde të larta të përkujdesjes ndaj pacienteve.
- Mirësjellja, kujdesi dhe respektimi i pacientit dhe personelit punues.
- Mirësjellja dhe bashkëpunimi profesional me stafin tjetër punues.
- Pranimi, ekzaminimi e trajtimi përkatës i pacientit.
- Kryen evidencimin e rregullt përmes dokumentacionit mjekësor (historia e sëmundjes, fletëshimi, protokollit etj) të pacientit.
- Kryen vizitat e rregullta tek pacientët e shtrirë në institucionin shëndetësor.
- Bëjnë kërkesa për vizita plotësuese-konsultative,
- Mbikëqyrë realizimin e detyrave ditore të punës të stafit punues.
- Jep mendime profesionale për punën që kryen.
- Kryen detyra të tjera ashtu si kërkon mbikëqyrësi për mbarëvajtjen e punëve në institucionin ku është i punësuar.
- Kryen edhe detyra të veçanta kur i kërkon lidhur me profesionin e ngushtë specialistik që e ka.
- Është përgjegjës për hartimin e plan-programit të punës së tij individuale e kolektive në vendin e punës,
- Angazhon stafin punues në realizimin e detyrave ditore të punës,
- Siguron dhe zhvillon programe e kurse trajnimi profesional,
